

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

TIRANË

DISERTACION

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

**LIDHJA NDERMJET KALKULOZES RENALE, PESHES
TRUPORE DHE HIPERTENSIONIT ARTERIAL**

DISERTANTE: VALBONA BAJRAMI

UDHËHEQËS SHKENCOR: PROF. ALMA IDRIZI

TIRANË, 2016

**“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe
hipertensionit arterial”**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE**

TIRANE

DISERTACION

I PARAQITUR NGA ZJ. Valbona Bajrami
PER MARRJEN E GRADES SHKENCORE
“DOKTOR”
SPECIALITETI : NEFROLOGJI

TEMA:

**LIDHJA NDERMJET KALKULOZES RENALE, PESHES TRUPORE
DHE HIPERTENSIONIT ARTERIAL**

MBROHET ME DATE/.....2016 PARA JURISE :

- | | |
|------------------------------|------------------|
| 1. Prof. Margarita Resuli | Kryetar |
| 2. Prof. Myftar Barbullushi | Anetar (Oponent) |
| 3. Prof. Enver Roshi | Anetar (Oponent) |
| 4. Prof. Asc. Kiri Zallari | Anetar |
| 5. Prof. Asc. Edmond Pistuli | Anetar |

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

FALENDERIME

Në përfundim të këtij studimi të dua të falenderoj personat që ndihmuan në realizimin e tij.

Në radhë të parë, falenderoj me respekt dhe mirënjohje udhëheqësin tim shkencor, Prof. Alma Idrizi, e cila me durim dhe përkushtim më orientoi dhe më mbështeti në fazat e ndryshme të këtij studimi.

Gjithashtu, falenderoj Prof. Enver Roshin, për ndihmen e dhene per perpunimin statistikor te te dhenave.

Falenderoj te gjithe pacientet qe dhane aprovimin qe te dhenat e ekzaminimeve te tyre te perdoreshin per studimin tim.

INDEKSI I SHKURTIMEVE

HTA – hipertension arterial

PTH - parathormoni

TG - trigliceridet

HDL – lipoprotein me densitet te rritur (kolesterol i mire)

BMI – treguesi i mases trupore

CCB – kalciblokues

ARB - frenues te receptoreve te angiotenzines II

ACE-I – frenuesit e enzimes konvertuese te angiotenzines

β -Bllokues – Beta- bllokues

RTA – acidoza tubulare renale

CT - tomografi e kompjuterizuar (skaner)

DM – diabet mellitus

N – numri i pacienteve

P – vlera e probabilitetit

GFR- filtracioni glomerular

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

PASQYRA E LENDES

I.	PJESA TEORIKE	Faqe-4
I.1.	Pak histori per kalkulozen renale	Faqe-4
I.2	Epidemiologja	Faqe-6
I.3	Litogjeneza	Faqe-6
I.4	Faktoret e riskut	Faqe-7
I.4.1	Faktoret qe lidhen me individin	Faqe-7
I.4.2	Faktore qe ndikojne ne stilin e jetes	Faqe-10
I.4.3	Faktoret e lidhur me ambjentin ne te cilin jeton individi	Faqe-14
I.5	Natyra kimike e gureve dhe etiologja e tyre	Faqe-14
I.5.1	Guret kalcike	Faqe-14
I.5.2	Guret nga acidi urik	Faqe-19
I.5.3	Guret struvite (FOSFO AMONIO MAGNEZIANE)	Faqe-20
I.5.4	Guret cistinike	Faqe-22
I.5.5	Guret nga ksantina	Faqe-23
II.	PJESA STUDIMORE	Faqe-24
II.1	Qellimi i studimit:	Faqe-24
II.2	Materiali dhe metodat	Faqe-26
II.3	Analiza statistikore	Faqe-30
II.4	Rezultatet e studimit	Faqe-31
II.5	Diskutimi	Faqe-62

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

II.6	Konkluzioni	Faqe-65
II.7	Rekomandime klinike	Faqe-66
III	BIBLIOGRAFIA	Faqe-67
IV	ABSTRACT / ABSTRACT	Faqe-

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

LISTA E TABELAVE

Tabela 1:	Vlerat mesatare dhe deviacioni standart per te dhenat e vazhdueshme	Faqe-37
Tabela 2:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine sipas gjinise	Faqe-48
Tabela 3:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak sipas gjinise	Faqe-50
Tabela 4:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine sipas BMI	Faqe-52
Tabela 5:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak sipas BMI	Faqe-55
Tabela 6:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine tek femrat hipertensive dhe normotensive	Faqe-57
Tabela 7:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak tek femrat hipertensive dhe normotensive	Faqe-59
Tabela 8:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine tek meshkujt hipertensive dhe normotensive	Faqe-61
Tabela 9:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak tek meshkujt hipertensive dhe normotensive	Faqe-63
Tabela 10:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine per Total (F + M), hipertensive dhe normotensive	Faqe-65
Tabela 11:	Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak ne total (M +F) hipertensive dhe normotensive	Faqe-67

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

LISTA E FIGURAVE

Figura 1:	Fizpatologjia e formimit te gurit ne veshka	Faqe-7
Figura 2:	Faktoret e riskut per urolitiazet	Faqe-9
Figura 3:	Procesi multifactorial i formimit te gureve kalcium oksalate	Faqe-21
Figura 4:	Pamje guresh kalcium oksalate	Faqe-23
Figura 5:	Pamje guri kalcium fosfat	Faqe-23
Figura 6:	Mekanizmi i formimit te gureve nga acidi urik	Faqe-24
Figura 7:	Pamje guresh nga acidi urik	Faqe-24
Figura 8:	Mekanizmi i formimit te gureve struvite	Faqe-26
Figura 9:	Pamje guri struvite	Faqe-26
Figura 10:	Pamje guri nga cistina	Faqe-27
Figura 11:	Shperndarja sipas gjinise	Faqe-36
Figura 12:	Mosha mesatare dhe deviacioni standart sipas gjinise	Faqe-36
Figura 13:	Shperndarja e subjekteve sipas vendlindjes	Faqe-37
Figura 14:	Shperndarja e subjekteve sipas vendbanimit	Faqe-38
Figura 15:	Shperndarja e subjekteve sipas BMI dhe gjinise	Faqe-38
Figura 16:	Shperndarja sipas gjinise dhe presionit arterial	Faqe-39
Figura 17:	Shperndarja e subjekteve duhanpires sipas gjinise	Faqe-40
Figura 18:	Perdorimi i medikamenteve antihipertensive ACE-I	Faqe-41
Figura 19:	Perdorimi i medikamenteve antihipertensive ARB	Faqe-41
Figura 20:	Perdorimi i medikamenteve antihipertensive β-bllokues	Faqe-42
Figura 21:	Perdorimi i medikamenteve antihipertensive kalcibllokues	Faqe-43

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

- Figura 22: Perdorimi i medikamenteve antihipertensive diuretike Faqe-43
- Figura 23: Verat mesatare per citraturine sipas gjinise Faqe-45
- Figura 24: Vlerat mesatare per variablat ne gjak sipas gjinise Faqe-46
- Figura 25: Vlerat mesatare per variablat ne urine sipas BMI Faqe-50
- Figura 26: Vlerat mesatare per variablat ne gjak sipas BMI Faqe-9
- Figura 27: Vlerat mesatare per variablat ne urine ne subjektet femra me HTA dhe jo-HTA Faqe-9
- Figura 28: Vlerat mesatare per variablat ne gjak ne subjektet femra me HTA dhe jo-HTA Faqe-9
- Figura 29: Vlerat mesatare per variablat ne urine ne subjektet meshkuj me HTA dhe jo-HTA Faqe-9
- Figura 30: Vlerat mesatare per variablat ne gjak ne subjektet meshkuj me HTA dhe jo-HTA Faqe-9
- Figura 31: Vlerat mesatare per variablat ne urine ne subjektet Meshkuj + Femra me HTA dhe jo-HTA Faqe-9
- Figura 32: Vlerat mesatare per variablat ne gjak ne subjektet Meshkuj + Femra me HTA dhe jo-HTA Faqe-9

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

I. PJESA TEORIKE

I.1 PAK HISTORI PER KALKULOZEN RENALE

Urolithiaza eshte nje nga semundjet me te vjetra e njohur ne qeniet njerezore. Baza e shkences se avancuar dhe historia e semundjeve te gureve urinare i perkon Egjiptianeve te lashte dhe Mesopotamise.

Hipokrati shpjegoi simptomat e gureve te vezikes urinare dhe sugjeroi se pirja e ujit te turbullt nga lumenjete, shkakton prezencen e reres ne urine.

Cornelius Celsus dha detajet e para mbi “Lithotomine Perineale”.

Guret urinare jane gjetur ne mbetjet e Mumjeve Egjiptiane qe datojo ne para 7000 vjetesh. Ne 1901 arkeologu anglez E.SMITH gjeti nje gur ne veziken urinare tek mumja El Emrah 4500-5000 vjecare ne Egjipt. Trajtimet per guret renale jane permendur ne mjekesine e lashte Egjiptiane ne shkrimet prej viteve 1500 B.C. [1, 2]. Literatura e hershme e semundjeve te gureve, ku pershkruhen simptomat, trajtimi eshte ajo e Asutus ne Mesopotami, midis 3200-1200 B.C. Pershkrimet e para te “Copezimit”, thermimit te gurit jane gjetur ne shkrimet Hindu dhe ato greke. Sushruta ishte nje kirurg qe jetoi ne Indine e lashte dhe eshte autor i librit “Sushruta Samhita”, ne te cilin ai pershkruan mbi 300 procedura kirurgjikale, perfshire edhe litotomine perineale dhe formimin e gureve te vezikes [3, 4]. Por egjiptianet e lashte dhane edhe keshilla dietetike. Ne ate kohe Litotomia u praktikua me incision perineal prej litotomisteve te afte, por Hipokrati theksoi se plaget e vezikes ishin vdekjeprurese [5]. Ammonius i Aleksandrise, (ne vitet 276 B.C) [6] ishte I pari qe sygjeroi thermimin e gureve per te lehtesuar zhvendosjen dhe daljen e tyre. Ai e fiksoi gurin me nje cengel dhe me pas e copetoi duke perdorur nje instrument te holle me fund preres. Ideja e tij nuk fitoi shume popullaritet ne ate kohe.

Cornelius Celsus (25 B.C - 40 A.D), ka sqaruar i pari Litotomine Perineale. Ai jetoi ne Rome dhe shkroi nje enciklopedi mjekesore “DE MEDICINA” [1, 6, 7]. Gjate periudhes se mesjetes (1096-1438), kishte pak mundesi ne menaxhimin e semundjeve te gureve [10, 11]. Ne kete periudhe litotomistet ishin udhetare komerciale qe zhvendoseshin nga nje qytet ne tjetrin dhe shihnin mundesite per biznes, shpesh te paedukuar, te korruptuar dhe i benin gjerat per tu dukur. Procedura zakonisht realizohej ne publik pa anestezi dhe zgjaste pak minuta, megjithate ata mbanin perjegjesi per rezultatet e keqija.

Ne periudhen e Rilindjes ndodhi nje rritje e shpejte ne kreativitetin intelektual ne shume fusha. Gjate kesaj periudhe procedurat mund te provoheshin tek te denuarit. Si rezultat, Calat i hoqi guret nje denuari me 1475 dhe me vone familja e tij ne France trashegoi nje monopol litotomie per 2 shekuj [1, 13].

Ne shekullin e 15-te, dy mjeke turq peshkruan ne menyre te pavarur nje teknike te copetimit transurethral te gurit dhe kateterizimit te vezikes [15]. Heqja e pare e nje guri

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

me litotomi suprapubike u realizua prej Pierre Franco ne 1561 [13]. Megjithese pacienti i tij rekuperoi mire, Franco i keshilloi te tjeret te mos ndiqnin shembullin e tij per shkak te riskut te larte.

Hermann Boerhaave (1668-1738) ishte nje prej figurave te rendesishme te shek te 18-te ne mjekesi [18]. Ai i kushtoi nje kapitull ne librin e tij “Institutiones Medicae” trajtimit te gureve ne traktin urinar, pasi litotomia duhej pare si alternative e fundit ne heqjen e tyre. Keshtu ai dha rekomandime si: marrja e shtuar e ujit, nje banjo me uje te ngrohte per te induktuar vazodilatacionin dhe ushtrime te ndryshme fizike. Litotripti u krijua prej Jean Civiale, qe u perdor per te realizuar litotripsi transuretrale, e cila njihet si metoda e pare per te thyer guret brenda vezikes minimalisht invasive per tu realizuar pa litotomi.

Young ishte i pari qe raportoi ureteroskopine me 1929 [31].

Por me shpikjen e makines qe realizonte goditjet ekstrakorporale ndodhi nje ndryshim thelbesor ne menaxhimin e gureve renale.

Historia e gureve urinare u be me e njohur prej personave te famshem qe mbanin semundjen.

Zhvilluan gure te vezikes urinare: Mbreti Leopold I i Belgjikes, Luis XIV, George IV, Oliver Cromwell, Benjamin Franklin, anatomisti Scarpa [13].

Mikelangelo qe mendohet te kete patur autizem, gjithashtu ka patur gure urinare[20]. Depresioni, guta, kolika renale nuk e ndaluan zakonin e te punuarit ne menyre obcessive. Semundja e tij terminale me simptomat e mbingarkeses ne likide mendohej se mund te kishte nefropati obstruktive.

Impresionuese eshte mantela e Krijuesit ne pikturen e tij te ndarjes se tokes dhe ujit ne “CISTINE CEILING”, e cila ka formen e veshkes se djathte te ndare ne dy gjysma.

Napoleon Bonaparti dhe perandori Napoleon III kane vuajtur prej gureve te vezikes dhe kishin siptomat e kolikes renale [13]. Sot historianet diskutojne se cfare do te kishte ndodhur ne fushaten ruse te 1812 neqoftese N.Bonaparti nuk do te kishte gure ne veziken urinare.

Nepermjet modifikimit te “Litotriptit Primitiv” te formuar prej Albucasis, Jean Civiale paraqiti nje forceps me tre dhembe dhe nje instrument copezues me 1824 [21]. Me 1874, Bigelow krijoi nje litotript te forte i cili u vendos ne vezike me ndihmen e anestezise, mbushi veziken, copetoj guret dhe i nxorri jashte te fragmentuar ne copa shume te vogla [22]. Kjo metode e copetimit te gureve u quajt “LITHOLOPAXY”. Papritur shkalla e mortalitetit u ul nga 25% ne 2.4%. Te dhenat e para ekografike per shkaterrimin e gureve urinare u raportuan perj Mulvaney me 1953 [36].

Pedorimi i lazerit per fragmentimin, copetimin e gurit ureteral filloji te perdorej ne 1986 [35]. Avancimet ne endoscope, ne instrumente te tjere, perdorimi i ESWL

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

(Extracorporeal Shock Wave Lithotripsy) coi ne menaxhimin me te mire te semundjeve te gureve renale duke parandaluar demtimin renal dhe insuficiencen renale.

I.2 EPIDEMIOLOGJI

Mesatarisht prevalanca globale shkon 5-64%. Ne Evrope prevalanca eshte midis 5-9 % [71]. Megjithate ka edhe raste te vecanta te studiuara se fundmi ne Greqi eshte gjetur nje prevalence 15% ne popullaten rurale ne Thebes [45].

Kjo rritje eshte pare ndermjet sekseve, rraces dhe moshes. Preken me shume meshkujt se femrat, ne raport 2:4 : 1, megjithate ne studimet epidemiologjike ne SHBA shihet nje rritje e prevalences ne grata dhe sidomos ne ato qe jetojne ne lartesite e jugore. Ne kete kontinent meshkujt ne jug kane nje prevalence 12% ne krahasim me 7% te atyre qe jetojne ne veri [46].

Persa i perket rraces prevalanca dhe incidence eshte me e larte tek rraca e bardhe e ndjekur nga hispaniket, rraca e zeze dhe aziatiket.

Eshte vleresuar se ne pothuajse ne 50% te pacienteve qe kane gure ne veshka, pas trajtimit te semundjes, ekziston mundesia e perseritjes brenda 10 vjetesh.

I.3 LITOGENEZA

Formimi i gureve ose litogjeneza kalon neper 3 faza:

1. Formimi i nukleusit ose berthames se gurit;
2. Grumbullimi i kristaleve;
3. Rritja e gurit;

Faza e pare perkon me kalimin e lendeve minerare nga gjendja e lenget ne gjendje te ngurte, gjate se ciles krijohen kushte per formimin e kristaleve te vegjel.


Faza e dyte perkon me fillimin e procesit te bashkimit te kristaleve nuk eshte gje tjeter vecse perqatitore per fazen e trete.

Ne *fazen e trete* guri zmadhohet duke veshtiresuar eleminimin e tij nepermjet urines [47].

Zhvillimi i ketyre fazave kushtezohet nga shume faktore, shumica e te cileve jane te panjohur.

Figura 1. Fizpatologja e formimit te gurit ne veshka

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”



Pa dyshim mbingopja e urines luan rol kryesor ne rritjen e gureve. Mbingopja e urines me nje kripe gureformuese pakeson aftesine tretese te urines per kete kripe, duke favorizuar kristalizimin e saj, ndersa aftesia tretese e urines per kete kripe varet nga shume faktore ku me thelbesoret jane “Ph Urinar” dhe “Vellimi Urinar”.

Urina normale ushtron nje veprimitari frenuese te kristalizimit, e cila tek njerezit qe formojne gure eshte me e vogel se te njerezit normal, c’ka shpjegon arsyen se perse per te njejtën shkalle mbingopje urine disa njerez formojne gure dhe disa jo.

I.4 FAKTORET E RISKUT

Faktoret qe ndikojne ne rritjen e riskut per zhvillimin e kalkulozes renale jane te lidhur me individin dhe me ambientin ne te cilin jeton, stilin i jetesës dhe kushtet e punes:

I.4.1 Faktoret qe jane te pamodifikueshem:

- a. Gjinia,
- b. Mosha,
- c. Etniciteti
- d. Trashegimia familjare[54]

I.4.2 Faktoret qe lidhen me stilin e jetesës:


- e. Dieta
- f. Dehidratimi
- g. Mbipesha, obeziteti
- h. Diabeti
- i. Hipertensioni
- j. Stresi etj.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

I.4.3 Faktoret e lidhur me ambjentin ne te cilin jeton individi [66]:

- k. Kushtet e punes
- l. Kushtet gjeografike
- m. Klima
- n. Temperatura

Figura 2. Faktoret e riskut per urolitiazë



I.4.1 Faktoret qe lidhen me individin

a. *Gjinia dhe Mosha* [48]:

Raporti Meshkuj – Femra ka respektivisht vlerat $2\div 4 : 1$.

Shumica e gureve urinare krijohen ne moshen 20-50 vjec.

Kater ne cdo pese paciente me kalkuloze renale jane burra.

Burrat midis moshes 30-50 vjec jane me te predispozuar te formojne gure te aparatit urinar.

Grate normalisht eleminojnë me shume citrate dhe me pak calcium se burrat normale, ndoshta nje arsyre perse burrat formojne gure me shpesh.

Piku per grata eshte rrith moshes 50 vjec dhe kjo shpjegohet me nivelin e ulet te estrogeneve ne menopause [63]. Ne grata e reja me teper zhvillohen guret ne stendet e fundit te shtatezanise dhe kjo shpjegohet me tendencen qe kane grata per te marre me shume kalcium. Per grata ne shtatzani mundesia qe te kete kalkuloze eshte ne raportin 1:1500.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Ne femije guret zakonisht krijohen nga faktore gjenetike. Shume here shkak eshte hiperkalciuria. Deformimet e traktit urinar krijojne nje risk te shtuar domethenes per formim guresh.

Femijet e lindur me peshe te vogel te cilet e kane te nevojshem marrjen e ushqimit intravenoz Jane me te riskuar per gure.

Ne adoleshence risku per formimin e gureve rritet dyfish sidomos ne moshen 25 vjec. Megjithate nuk jane te qarta arsyet pse ne kete moshe eshte risku me i madh per formimin e gureve, mendohet se kjo ka te beje me peshen trupore e cila fillon te rritet ne te rinjte ne kete moshe.

b. Etniciteti [49] [50]

Nga studimet e bera eshte konkluduar qe rrisku me i larte per formimin e gureve renale eshte tek raca e bardhe e ndjekur nga rraca Hispanike, raca e zeze dhe raca Aziatike.

c. Trashegimia ose historia personale per gure renale

Rrisku per formim guresh eshte me i larte tek personat qe ne trashegimine familjare kane patur presence te kalkulozes renale [51].

Rreth gjysma e njerezve qe kane patur gure ne veshka kane tendenze te riformojne perseri gure brenda 5 vjetesh [53].

C’rregullimet gjenetike te trasheguara luajne rol per formimin e disa lloj guresh [52]. Guret nga cistina ndodhin kur cistinuria eshte e rritur kjo si shkak i c’rregulimeve te trasheguara gjenetike ne transportin e aminoacideve.

Disa semundje hereditare qe luajne rol per formimin e gureve renale jane [54]:

- Hiperoksaluria primare tip I dhe tip II
- Cistinuria
- Sindromi Bartter tip III dhe tip IV
- Hipomagnezemia familjare
- Hiperkalciuria autosomale dominante hipokalcemike
- Acidoza tubulare distale hereditare renale

Ne anomalite anatomike te aparatit urinar permendim:

- Veshka si sfungjer (Medulary Sponge Kidney)

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial"

- Sistemi pielo-ureteral dyfish
- Reni Polikistik
- Patologjia e segmentit

I.4.2 Faktore qe ndikojne ne stilin e jetes

a. Dieta:

Dieta e pasur me proteina, kripe, karbohidrate dhe ushqime te pasura me oxalate, rritin riskun per formim guresh ne veshka. Njerezit, dieta e te cileve eshte e pasur me proteina shtazore dhe e varfer ne fibra dhe lengje kane risk me te larte[61].

Faktoret dietetike luajne nje rol te rendesishem ne formimine gureve renale dhe kane luhatje ne shekuj. Piku i kalkulozes renale ndodh gjate periudhes se begatise dhe episodet e tyre jane me te rralla ne periudha luftrash [57]. Roli i shume perberesve si kalcium, oksalate, magnez, fosfor, natrium, kalium , proteina ka qene nen vezhgim, per shkak te efekteve te tyre te njohura ne ekskretimin urinar si promotore apo inhibitore te formimit te gurit.

Kalciumi: Ne te shkuaren kufizimi i kalciumit u be nje rekondit popullor, bazuar ne incidenten e larte per hiperkalciurine [60]. Shumica e pacienteve hiperkalciurike kur iu nenshruan nje marrje te rritur te kalciumit, nuk paraqiten nje rritje te eliminimit te tij. Ne kushtet.e marrjes se paket te kalciumit, pacientet paraqiten nje eleminim te shtuar te kalciumit ndaj dieta u konsiderua si e pavarur nga kalciumi [59]. Marrja e suplementeve te kalciumit mund te rrise rrezikun per gure, sepse kalciumi ne diete redukton absorbimin e oksalateve. Lidhja midis marrjes se kalciumit dhe formimit te gurit varion me moshen pasi mosha dhe masa e trupit ndikojne ne lidhjen midis dietes dhe gureve renale. Ekskretimi i kalciumit ndikohet jo vetem nga marrja e kalciumit por edhe nga proteinat shtazore, natriumi, oksalatet dhe kaliumi. Sot shume eksperte keshillojne marrje te rritura te kalciumit ne diete. Zevendesimi i proteinave shtazore me produkte te derivuara, con ne rritjen e marrjes se fosfateve qe bashke precipitohen me kalciumin ne lumenin intenstinal. Keshtu qe fosfati urinar nuk rritet, pasi kalciumi dhe magnezi konkurojne per nje mekanizem reabsorbues ne ansen Henle. Rritja e eleminimit te kalciumit urinar indukton rritje te magnezit urinar, i cili eshte frenues i njohur ne agregimin re kristaleve.

Oksalatet: Ekskretimi i oksalateve varet jo vetem nga perberja e oksalateve, por gjithashtu nga efektiviteti, tretshmeria dhe forma e kripes me te cilin prezantohet. Kikiriket, caji bio, bajamet, cokollatat, arrat konsiderohen me risk te moderuar.

Ushqime me permbytje te larte oksalatesh jane:

- fasulet, birra, panxhari, manaferrat, boronica, selinoja, rrushi, patellxhani, lakra jeshile, preshi, limoni, bamjet, majdanozi dhe spinaqi[62].

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Magnezi: 5% e pacienteve me gure kane hipomagneziuri dhe urina e mbi 25% e pacienteve me gure ka ulje te raportit Magnez/ Kalcium. Hipomagneziuria mendohet te jete pasoje e marrjes se ulur te magnezit ne diete. Suplementet me kripeta te magnezit cojne ne frenim te formimit te gurit edhe kur pacienti nuk ka deficience te magnezit.

Fosfori: Ne pacientet me gure fosfatet ne urine mund te jete te rritura. Hiperfosfaturia korelon me nivelet e kalciurise. Ne fakt ka te dhena qe pacientet me hiperkalciuri idiopatike eleminojoje fosfate te shtuara.

Proteinat: Proteinat e shumta te marra me origjine shtazore kontribujne ne hiperurikozuri (si rezultat i mbingarkeses ne purina), hiperoksaluri (pasi rritet sinteza e oksalateve) dhe hipocitraturi (se rritet reabsorbimi tubular i citrateve).

Ne meshkujt me rekurence te formimit te gureve kalcium oksalate dhe me hiperkalciuri, kufizimi i marrjes se proteinave shtazore dhe kripes i kombinuar me marrje normale te kalciumit con ne nje mbrojtje me te mire.

Kaliumi: Nje studim epidemiologjik [56] konkludoj se sa me pak kalium te merret aq me i madh eshte rishku relativ per formimin e gurit. Borsatti studio me 1991 se nje marrje normale ose e ulur e kalciumit dhe marrja e rritur e kripes cojne ne formim guresh kur krahasohej me subjektet e shendetshem. Efekti final ishte raporti natrium/kalium i rritur, cka con ne shtim te riskut per formim guresh.

Natriumi: Efekti i kripes se marre ne diete con ne rritjen e shtuar te eleminimit te kalciumit. Nje marrje e shtuar e kripes ul ekskretimin e citrateve.

Likidet: Nje marrje e shtuar e lengjeve eshte e nje rendesie te madhe per te reduktuar supersaturimin e urines. Ne nje studim 5 vjecar ku u perfshire paciente me episode te formimit te gurit per here te pare u pa shkalle e ulet e rekurencese se gurit (12%), ne ata me marrje te shtuara te lengjeve, krahasuar me ata me marrje te paket lengjesh (27%). Uji me sasi te larta bikarbonatesh rrit ekskretimin e citrateve dhe magnezit. Bazuar ne keto te dhena akoma nuk eshte percaktuar qarte qe uji i forte i pasur me kalcium dhe magnez eshte me litogenik se uji i bute[58].

Pra ndikimi i dietes ne kalkulozen renale eshte shume me kompleks sec ka qene ne te shkuaren, sepse shume bashkeveprime zene vend midis ushqimeve te ndryshme qe luhatin parametrat urinare.

b. Dehidratimi

Mos konsumimi i mjaftueshem i ujit cdo dite rrit rriskun [55] per gure ne veshka. Njerezit qe jetojne ne vende me klime te nxehte dhe ata qe djersitin shume jane me shume te rriskuar se te tjeret.

c. Mbipesha dhe obeziteti

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Te dy keta faktore shoqerohen me rritje te rriskut per gure renale. Shkencetaret mendojne qe ekziston nje lidhje ndermjet acideve yndyrore, insulino rezistences dhe perberjes se urines. Njerezit me peshe te madhe trupore ekskretojne me shume calcium dhe acid urik ne urine cka rritin rriskun per formimin guresh renale. Tek individet obeze me $BMI > 30 \text{ kg/m}^2$ incidenca per gure renale shkon 4.9% ne krahasim me ata jo-obese qe shkon 2.6%.

d. Diabeti mellitus

Diabeti Mellitus eshte nje faktor rrisku madhor per formimin e gureve ne veshka. Eshte pare qe prevalence e kalkulozes ne pacientet diabetike eshte 21%, dhe ne ata pa diabet 8% [67].

Diabeti Tip II rrit rriskun per formimin e gureve ne per gjithesi, por vecanerisht rrit rriskun per formimin e gureve nga acidi urik. Njerezit me DM Tip II kane me shume acide ne urine, gje qe rrit rriskun per formimin e gureve nga acidi urik. Eshte pare qe prevalence e diabetit mellitus tip II eshte 3 here me e larte tek pacientet me gure nga acidi urik, ne krahasim me pacientet me gure kalcike [68].

e. HTA-

Njerezit me presion te larte te gjakut jane te perdispozuar tre here me shume per te formuar gure ne veshka sesa ata normotensive [69]. Nuk eshte plotesisht e qarte nese duke patur presion te larte te gjakut rritet rrisku per gure apo guret shkaktojne rritje te presionit te gjakut ose eshte nje faktor qe i lidh te dy kushtet.

Nga studime te ndryshme epidemiologjike hipertensioni lidhet me rritjen e frekuencies per nefrolitiaz, pavaresisht moshes, mases trupore ose funksionit renal. Kohijimoto [116] dhe bashkepunetoret e tij konfirmuan nje lidhje te HTA dhe tipeve te ndryshme te gureve ne nje studim te gjere, pavaresisht moshes, seksit dhe te dhenave te tjera te sindromit metabolik. Megjithate kuptimi i vertete i kesaj lidhjeje mbetet i panjohur. Lidhja midis acidit urik dhe HTA eshte pershkruar ne vitet 60 dhe nga studimet rezultoi qe 26% e pacienteve me HTA te patractuar dhe me funksion renal normal kishin nivele te rritura te acidit urik ne gjak [117]. Hiperuricemia nxit fillimin e HTA nepermjet kaskades inflamatore me disfunkcion endothelial dhe proliferim te qelizave te muskulatures se lemuar duke cuar ne zhvillimin e arteriolosklerozes renale afferente. Mbi te gjitha HTA eshte nje nder bashkeshoqueruesit e guates, duke prekur afersisht 74% te pacienteve me artropati guzoze sic eshte pershkruar ne nje studim te 2007(US Nacional Health and Nutrition Examination Survey) [118].

Disa medikamente hipertensive si diuretiket dhe b-bllokuesit rrisin nivelin e acidit urik ne gjak duke modifikuar zhvillimin e guates. Te dhenat e fundit sygjerojne se hiperuricemia mund te rrise rriskun per zhvillimin e semundjeve renale dhe kardiovaskulare. Nuk dihen akoma benefitet e perdonimit te inhibitoreve te xanthine –

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

oxidazes ne pacientet qe jane asimptomatike me hiperuricemi dhe me rrisk kardiovaskular.

f. Stresi

Personat qe bejne nje jete stresante jane me te predispozuar per formim guresh renale se te tjeret dhe kjo lidhet me rritjen e hormonit vazopresine, i cili ul volumin e urines dhe ben te mundur koncentrimin e urines e prirur per formimin e kristaleve ne urine.

g. Guta

Guta eshte nje forme e artritit inflamator qe shkaktohet nga rritja e tepert e acidit urik ne gjak. Haset me shume tek meshkujt dhe femrat ne menopause. Simptomat e gutes shkaktohen nga grumbullimi i kristaleve te acidit urik ne artikulacione. Jo te gjithe pacientet me hiperuricemi zhvillojne gute dhe jo te gjithe ataket e gutes ndodhin kur personat kane hiperuricemi. Rastet me gute te avancuar mund te cojne ne formimin e gureve ne veshka, pasi ndodh depozitimi i kristaleve te acidit urik ne veshka. Guta shkakton demtime permanente ne artikulacione dhe ne veshka. Normalisht duhet nje kohe e gjate afersisht 10 vite pa ndonje trajtim, qe kjo semundje te avancoje dhe te jape demtime ne veshka dhe artikulacione.

h. Hiperparatiroidizmi

Gjendra paratiroide irregullon nivelin e kalciumit ne trup nepermjet hormonit paratiroid. Disa njerez me hiperparatiroidizem zhvillojne gure ne veshka. Paratiroidektomia ne disa njerez ndikon ne reduktimin e riskut per formim guresh por rruku akoma ngelet i larte per disa kohe pas kirurgjisë.

i. Semundjet digestive dhe kirurgjia

Semundjet inflamatore te zorres si M.Crohn [73] dhe koliti ulceroz shkaktojne ndryshime ne proceset e tretjes qe ndikojne ne perthithjen e kalciumit dhe ujit, si rrjedhim rritet niveli i ketyre substancave gureformuese ne urine kryesisht ne burrat.

j. Semundjet e traktit urinar

1.Polikistoza renale

Nefrolitiaza eshte nje manifestim i semundjes se polikistozes me nje frekuence 8-36%. Ne studime te ndryshme tek keta paciente formimi i gureve haset 2 here me shume se ne popullaten e per gjithshme. Te dhenat e fundit sugjerojne qe etiologjia e kalkulozes ne rastet me polikistoze eshte me natyre multifaktoriale, perfshire faktore metabolike dhe anatomike [121,122,123,124,125].

2. Semundja e renit sfungjer (Medullary Sponge disease)

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Eshte nje semundje kongenitale e veshkave e karakterizuar nga dilatazioni kistik i tubujve kolektore ne nje ose ne te dy veshkat. Teori te tjera sygjerojne qe dilatazioni i duktusit kolektor mund te vije prej okluzionit prej acidit urik gjate jetes fetale ose mund te rezultoje nga obstruksioni tubular prej gureve te oksalateve te kalciumit ,ne menyre sekondare nga hiperkalciuria infantile[126]. Ne 70 % te pacienteve me ren sfungjer mund te shfaqen gure.

3. Infekzionet rekurente te traktit urinar

Studimet jane fokusuar kryesisht ne aftesine e baktereve per zhvillimin e gurit.Nje prej formave me tipike te litogenezes infektive eshte nefrolitiaza nga guret struvite qe karakterizohet nga gure te medhenj qe mbushin pelvisin renal[127].

4.Refluksi veziko-ureteral

Problemi kryesor me refluksin eshte ekspozimi ndaj infekzionit te veshkave.Tek femijet, sidomos tek ata ne 6 vitet e para te jetes, infekzioni mund te shkaktoje demtim te veshkes dhe formim guresh me vone.

5.Patologjia e segmentit

Si pasoje e stenoze se ureterit favorizohet staza urinare dhe kalkuloza.

k. Demtimet e shtylles kurrizore

Infekzionet e perseritura urinare, kateteret e perhershem urinar, refluksi veziko-ureteral jane disa nga faktoret e riskut per zhvillimin e urolitiazes midis pacienteve me demtime te shtylles kurrizore [128]. Identifikimi i hershem dhe trajtimi i gureve renale, minimizojne komplikacionet shoqueruese dhe mbajne te ruajtur funksionin renal.

l. Medikamentet

AIDS medikamente. Me shume se 10% e pacienteve me AIDS qe marrin indinavir zhvillojne gure urinare. Rrisku eshte i rritur ne patientet me AIDS qe kane hepatit B, hepatit C ose hemofili ose tek ata qe marrin antibiotike te kombinuar trimethoprine-sulfametoxazole.

Medikamente te tjera. Guret ne veshka rralle jane efekt anesor i hormoneve te tiroides ose diuretikeve te anses Henle (medikamente qe rritin urinimin), megjithate diuretiket perdoren per preventimin e gureve kalcike.

Barnat kimiopreparate gjithashtu shkaktojne gure ne veshka.

Perdorimi per kohe te gjate i medikamenteve antiacide, te cilet ndryshojne permbajtjen ne urine te acideve rritin rriskun per gure renale, etj.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

I.4.3 FAKTORET E LIDHUR ME AMBJENTIN NE TE CILIN JETON INDIVIDI

- a. Kushtet e punes. Jeta sedentare rrit rriskun per formimin e gureve urinare.
- b. Kushtet gjeografike / klimaterike. Persa i perket klimes dhe temperatures guret jane me te shpeshte ne zona me klime te nxehete, kjo per arsyte dehidrimit. Parametrat e ujit ne vende te ndryshme rrisin rriskun e formimit te gureve, kur ata permabajne sasi te medha mineralesh.

I.5 NATYRA KIMIKE E GUREVE DHE ETIOLOGJIA E TYRE

Guret renale ndahen sipas kategorive te meposhtme:

1. Guret Kalcike:

-Oxalate Kalciumi

-Fosfate kalciumi

2. Guret nga acidi urik

3. Guret struvite (fosfo-amonio-magneziane)

4. Guret nga cistina

5. Guret nga ksantina etj.

I.5.1 GURET KALCIKE

Perbejne rreth 80% te te gjithe gureve renale [81] [82]. Burrat preken 2 here me shume se grata. Njerezit me moshe 30-50 vjec kane nje rrisk me te larte per te formuar gure kalcike. Reth 75% te gureve kalcike jane oksalate dhe nje perqindje e vogel jane fosfate ose te perzier.

Etiologjia e gureve kalcike

Hiperkalciuria

Hiperkalciuria ndahet ne Resorptive; Absorptive; Renale. Reth 30% e gureve kalcike shoqeroohen me hiperkalciuri [75].

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Hiperkalciuria resorptive

Ajo vjen si rrjedhoje e shtimit te calciumit ne filtratin glomerular, qe vihet re zakonisht gjate demineralizimit kockor Shkaqet kryesore te hiperkalciurise resorptive jane:

1. Hiperparatiroidizmi paresor (adenoma e paratiroides), i cili perben shkakun e 3-5 % te gureve kalcike [73]. Formim i i gureve favorizohet nga hipercalciuria dhe rritja e pH-it te urines. Hiperkalciuria eshte pasoje e drejtoperdrejtje e hiperkalcemise qe vjen nga shtimi i thithjes se calciumit ne zorre dhe sidomos nga shtimi i rezorbimit te tij ne kocka. Ne te vertete shtimi i PTH rrit edhe rithithjen tubulare te kalciumit, por megjithate ky veprim nuk mund te pengoje shtimin e eliminimit urinar te kalciumit. Pervec ketyre PTH pakeson rithithjen tubulare te fosforit dhe pengon ekskretimin e joneve te hidrogenit. Diagnoza e hiperparatiroidizmit paresor eshte e veshtire, sidomos ne ato raste qe nuk kane hiperkalcemi te larte, prandaj duhen bere matje te perseritura te PTH.
2. Acidoza tubulare distale [76]. Eshte nje lloj tubulopatie e trasheguar e femijeve qe shkakton acidoze metabolike, crregullime kockore, vonese te rritjes dhe shoqerohet shpesh me nefrocalcinoze. Acidoza favorizon daljen e kriperave te kalciumit nga kockat ne gjak, duke shkaktuar nga njera ane varferimin e kockave ne kalcium dhe nga ana tjeter shtimin e kalciumit ne gjak dhe urine.

Shkaqe te tjera me te rralla jane edhe hipertiroidizmi, imobilizimet e gjata post-traumatike, poliomeliti, etj.

Hipercalciuria absorptive

Mekanizmi baze fiziopatologjik i hiperkalciurive absorptive eshte shtimi i thithjes se kalciumit ne zorre qe con ne rritjen e perqendrimit plazmatik te tij si dhe ne shtimin e sasise se kalciumit qe do te filtrohet nga glomerulat duke shkaktuar ne kete menyre hiperkalciuri [74] [76]. Shtimi i perqendrimit te kalciumit ne gjak e frenon sekretimin e PTH e per rrjedhoje do te pakesohet riabsorbimi tubular i kalciumit. Keshtu do te theksohet kalciuria duke penguar rritjen e metejshme te kalcemise. Gjate hiperkalciurive absorptive kufizimi i kalciumit ushqimor e frenon perkohesisht hiperkalciurine, e cila rishfaqet perseri edhe kur i semuri merr sasira normale kalciumi. Ne kete grup futen edhe hiperkalciurite qe vihen re gjate sarkoidozes dhe intoksikimit me vitamine D.

Hiperkalciurite renale

Mekanizmi baze fispatologjik i hiperkalciurive renale eshte pakesimi i rithithjes tubulare te kalciumit qe vjen ne veshka nepermjet filtratit glomerular. Keta te semure

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

kane hiperkalciuri esell [76]. Hiperkalciurite renale jane kronike, prandaj si rrjedhoje zhvillohet hiperparatiroidizmi sekondar, i cili shton thithjen ne zorre te kalciumit, si dhe rezorbimin kockor te tij, duke shkaktuar demineralizimin kockor. Edhe gjate PTH sekondar, ashtu si edhe ne PTH primar kemi rritje te PTH ne gjak dhe te AMPc ne urine. PTH sekondar qe krijohet nga hiperkalciuria mund te frenohet duke i dhene te semurit sasira te medha kalciumi nga goja, ose duke penguar humbjen renale te kalciumit. Per te penguar humbjen renale te kalciumit perdoren diuretiket tiazidike, te cilet frenojne thithjen e natriumit dhe nxisin thithjen e kalciumit ne tubin proksimal.

Hiperoxaluria

Hiperoksalaturia ndahet ne 4 tipe:

1. hiperoksalaturia primare (Tip I, TiP II) [77] [78];
2. hiperoksalaturia enterike (malabsorbimi - M. Crohn);
3. hiperoksalaturia nga dieta;
4. hiperoksalaturia idiopatike (qe jane rezultat i proceseve te ndryshme patofiziologjike).

Hiperoksalaturia Primare (Tip I, TiP II)

Eshte e nje forme e rralle per shkak te defekteve gjenetike qe shkaktojne humbjen e aktivitetit te enzimes specifike (enzimes oksalate).

Hiperoksalaturia Tip I eshte me shpeshte se ajo Tip II, ajo ndodh ne 1 per 120.000 lindje dhe transmetohet si tipar recessiv autosomal.

Hiperoksalaturia Tip II eshte me rralle se ajo Tip I. Per shkak te saj stimulohet shnderrimi i glikoksalateve ne oksalate.

Hiperoksalaturia Enterike

Perben rreth 5% te rasteve te hiperoksalaturise. Per shkak te problemeve gastrointestinale zakonisht shoqerohet me diarre kronike. Malabsorbimi per shkaqe te ndryshme mund te rezultoje me *hiperoksalaturi entetrike*.

Keto shkaqe perfshijne sindromen e shtimit te baktereve ne zorre, malabsorbimin e yndyrnave, semundjet biliare kronike ose pankreatike, procedurave te ndryshme te nderhyrjeve kirurgjikale intestinale, semundjeve inflamatore te zordes, dhe gjendje te ndryshme kline qe skaktojne diare kronike.

Hiperoksalaturia nga dieta

Me pare hiperoksalaturi nga dieta mendohej se luan një rol te vogel, 10 – 20% te oksalateve totale qe prodhoheshin ne urine. Ne studimet e fundit kane nxjerre qe dieta luan një rol te rendesishem dhe eshte perqejgjese per 50% te oksalateve ne urine.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Konsumi i larte i ushqimeve me permbajtje te larte te oksalateve si cokollateve, spinaqit, arroreve, dhe dieta e pasur me proteina shtazore cojne ne hiperoksalaturi.

Dietat me permbajtje te vogel te kalciumit mund te rezultojne me hiperoksalaturi nepermjet uljes se aftesive lidhese te oksalateve ne zorre duke rritur absorbimin.

Acidi Askorbik (Vitamina C) mund te konvertohet ne oksalate duke sjelle keshtu rritjen e oksalateve ne urine.

Hiperoksalaturia idiopatike (qe jane rezultat i proceseve te ndyshme patofiziologjike)

Eshte forma me e zakonshme qe haset ne pacientet me gure oksalate kalciumi. Kjo forme mund te jete per shkak te dietes se tepruar me ushqime te pasura me oksalate ose nga rritje e prodhimit te oksalateve endogjene (per shkaqe te brendshme).

Hipocitraturia

Hipocitraturia eshte niveli i ulet i citrateve ne urine) [79].

Citatet luajne nje rol te rendesishem ne mekanizmin e formimit te gureve urinare.

Niveli i ulet i citrateve ne urine eshte faktor risku per guret e kalciumit. Hipocitraturia gjithashtu rrit riskun per gure te acidit urik. Shume shkaqe mund te reduktojne nivelin e citrateve duke perfshire:

- Acidoza renale tubulare distale (RTA)
Acidoza renale tubulare distale mund te jete e plote ose jo e plote.
Forma e plote karakterizohet nga acidoza metabolike hiperkloremike, hypokalemia dhe rritja e pH urinar, kurse forma jo e plote karakterizohet nga vlera normale te elektroliteve, bikarbonateve, klorit, pH ne gjak dhe fosfateve normal ne urine.
Te dyja format shoqerohen me hiperkalciuri dhe hypocitraturi te thelle.
- Mungesa e potassiumit ose magnezit
- Infekzionet e traktit urinar
- Marrja e diuretikeve tiazidike dhe acetazolamidit
- Dieta e pasur me proteina shtazore
- Marrja e shtuar e sodiumit
- Guta
- Ushtrime te renda fizike
- Diarrete kronike

Hiperurikozuria

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Hiperurikozuria gjithashtu luan nje rol te rendesishem ne disa gure te acidit urik. Hiperurikozuria ndodh ne 20% te njerezve (kryesisht meshkuj) me gure te oksalateve te kalciumit. Uratet, kriperat e formuara nga acidi urik, krijojne berthamen e kristalit, rrotull te ciles kristalet e oksalateve te kalciumit rriten. Disa gure priren te jene me agresive dhe rekurente. Ata lidhen fuqishem me nje marrje te shtuar te proteinave [80].


Te tjera

Ketu renditen anomali te aparatit genitourinar si veshka sfungjer, megakaliks kongenital.

Gjithashtu shkak mund te jete dhe perdonimi i tepruar i medikamenteve si: furosemidi, vitamina D, acetazolamide, suplemente te kalciumit, teofilina, amfotericina B.

Figura 3. Procesi multifactorial i formimit te gureve kalcium oksalate

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Figura 4. Pamje guresh kalcium oksalate



Figura 5. Pamje guri kalcium fosfat



I.5.2 GURET NGA ACIDI URIK

Rreth 5-15% e gureve urinare jane formuar nga acidi urik [81]. Shumica e pacienteve me gure nga acidi urik jane ne nje moshe mbi 60 vjec. . Pacientet ne moshe te re jane shpesh obeze.Vihet re nje tendence ne rritje e gureve nga acidi urik ne zonat urbane ne krahasim me ato rurale. Pacientet ne moshe te re jane shpesh obeze. Meshkujt preken 2-4 here me teper se femrat.

Guret nga acidi urik formohen vetem ne urine acide, pra pH urinar $\leq 5,5$ keshtu qe dieta luan nje faktor risku te rendesishem per formimin e gureve nga acidi urik. Dieta e pasur me proteina dhe purina me rritje te konsumimit te pijeve alkolike rezulton ne rritjen e ekskretimit te acidit urik dhe ne uljen e pH urinar. 20-40% e pacienteve me Guta me pas formojne gure te acidit urik. Keta paciente kane rritje te uricemise e cila rezulton me hiperurikozuri. Eshte e nevojshme te theksohet qe pacientet me ileostomi formojne me shpesh gure nga acidi urik sesa kalcium oksalate sepse kombinohet pH i ulet dhe sasia e paket e urines.

Gjithashtu Hiperurikozuria zhvillohet ne diarrete kronike, marrja e shtuar e purinave, sindromin e lizes tumorale, deficit i G-6-P dehidrogenazes.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Figura 6. Mekanizmi i formimit te gureve nga acidi urik





Figura 7. Pamje guresh nga acidi urik



I.5.3 GURET STRUVITE (FOSFO AMONIO MAGNEZIANE)

Guret struvite perbejne 4-6% te gureve te aparatit urinar dhe njihen gjithashtu si magnesium-ammonium-phosphate dhe jane gure qe zakonisht shkaktohen si rezultat i infeksionit urinar [81]. Ne Amerike guret struvite zene 10-15% te gureve te traktit urinar.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Guret struvite zhvillohen 2 here me shpesh ne femrat ne krahasim me meshkujt dhe sidomos ne moshat mbi 50 vjec, cka shpjegon dhe tendencen qe ka kjo moshe per te zhvilluar infeksione te perseritura te traktit turinar. Bakteret prodhojne nje enzime e cila rrit prodhimin e ammoniumit ne urine. Amoniaku formon kristalet qe me pas kthehen ne kalkula.

Bakteret urease prodhuese qe shkaktojne kalkulozen jane:

- proteus mirabilis
- providentia
- pseudomonas
- klebsiella
- ureaplasma
- staphylococcal aureus, etj.

Ph urinar ne pacientet me gure struvite zakonisht eshte i rritur, pH urinar >7 . Guret struvite ndryshe nga guret me baze kalciumi, rralle shfaqin kolike renale dhe shpesh jane asimptomatike deri sa guret zmadhohen se tepermi dhe infekzioni rritet. Keta gure mund te shoqerohen me pielonefrit ksantulogranulomatoz.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Figura 8. Mekanizmi i formimit te gureve struvite




Figura 9. Pamje guri struvite



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

I.5.4 GURET CISTINIKE

Cistinuria eshte nje crregullim autosomal dominant apo recessiv si rezultat i nje defekti tubular qe con ne rritjen e ekskretimit te cistines dhe tre aminoacideve te tjere (ornithine, arginine, lizine) [81].

Figura 10. Pamje guri nga cistina



Keta gure kane sulfur ndaj jane te dukshem ne grafi. Hasen ne dekaden e dyte dhe te trete te jetes. Jane gure te rralle dhe perbejne vetem 1% te gureve te aparatit urinar. Nje diete e zakonshme mund te nxise formimin e gureve cistinike. Pakesimi i sasise se urines dhe marrja e shtuar e proteinave shtazore dhe a kripes rrisin ekskretimin ne urine te cistines. Prandaj ne guret nga cistina eshte shume e rendesishme rritja e volumit urinar $>3.5\text{L}/24\text{h}$. Vecanerisht gjate nates 1.5 L urine eshte mire dhe duhet te arrihet.

I.5.5 GURET NGA KSANTINA

Guret nga 2,8-Dihydroxyadenine dhe ksantina

Jane gure shume te rralle dhe shkaktohen nga defekte autosomal recessivete i enzimes adenine phosphoribosyl transferaze dhe enzimes xanthine oxidaze [81].

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

II. PJESA STUDIMORE

II.1 Qellimi i studimit

Te studiohet korrelacioni ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial ne popullaten e marre ne studim dhe orientimi dietetik perkates.

II.1.2 Objektivat e pergjithshme

1. Pershkrimi i shperndarjes se popullates se marre ne studim sipas gjinise, moshes, vendlindjes, vendbanimit, duhanpirjes, BMI-se dhe presionit arterial (HTA ose jo HTA).
2. Pershkrimi i shperndarjes se subjekteve te marra ne studim sipas mjekimit te perdonur, ACE-inhibitore, ARB, beta-bllokues, kalcibllokues, diuretike.
3. Te analizohet korelacioni ndermjet kalkulozes renale, dhe shperndarjes se saj sipas peshes trupore dhe presionit arterial ne varesi te te dhenave biokimike dhe urinare ne popullaten e marre ne studim.

II.1.3 Objektivat specifike

1. Shperndarja e subjekteve ne studim sipas gjinise
2. Shperndarja e subjekteve sipas moshes
3. Shperndarja e subjekteve sipas vendbanimit dhe vendlindjes
4. Shperndarja e subjekteve sipas duhanpirjes
5. Shperndarja e subjekteve sipas BMI-se, te detajuar sipas Gjinise
6. Shperndarja e subjekteve sipas mjekimit te HTA
7. Shperndarja e subjekteve sipas presionit arterial (HTA dhe normotensive) te detajuar sipas gjinise.
8. Korrelacioni ndermjet kalkulozes renale me te dhenat e vazhdueshme te variablate te matur ne gjak sipas gjinise.
9. Korrelacioni ndermjet kalkulozes renale me te dhenat e vazhdueshme te variablate te matur ne urinen e 24 oreve sipas gjinise.
10. Korrelacioni ndermjet treguesit te mases trupore (BMI) me te dhenat e vazhdueshme te variablate te matur ne gjak.
11. Korrelacioni ndermjet BMI me te dhenat e vazhdueshme te variablate te matur ne urinen e 24 oreve.
12. Korrelacioni ndermjet presionit arterial (HTA ose jo-HTA) me te dhenat e vazhdueshme te variablate te matur ne gjak, e detajuar dhe sipas gjinise.
13. Korrelacioni ndermjet PA (HTA ose jo-HTA) me te dhenat e vazhdueshme te variablate te matur ne urinen e 24 oreve, e detajuar dhe sipas gjinise.

Me specifikisht per objektivat 8,9,10, 11, 12, 13 do te merren ne studim te dhenat

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

○ *Vlerat e vazhdueshme per variablat ne Urinen 24-oreshe:*

- ❖ Natriurise;
- ❖ Kaliurise;
- ❖ Calciurise;
- ❖ Fosfaturise;
- ❖ Citraturise;
- ❖ Magneziurise;
- ❖ Uricurise;
- ❖ Klorurise;
- ❖ pH Urinar.

○ *Vlerat e vazhdueshme per variablat ne gjak jane:*

- ❖ Natremise;
- ❖ Kalemise;
- ❖ Kalcemise
- ❖ Totale;
- ❖ Kalciumit te Jonizuar;
- ❖ Kloremise;
- ❖ Magnezemise;
- ❖ Uricemise;
- ❖ Fosfatemise;
- ❖ PTH-it;
- ❖ Astrupogrames;
- ❖ Glicemise;
- ❖ Kolesterolit Total;
- ❖ Triglycerideve.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

II.2 MATERIALI DHE METODAT

II.2.1 Pacientet:

Ne studim u perfshire 100 paciente me kalkuloze renale, te ndjekur ne spitalin IKEDA, gjate periudhes Prill 2011 - Dhjetor 2014.

II.2.2 Tipi i studimit prospektiv, “Case Seri”

II.2.3 Kriteret e inkludimit ne studim:

- ❖ Persona me kalkuloze renale
- ❖ Persona te moshave 18-70 vjec
- ❖ Funksion renal normal, GFR (filtracion glomerular) $\geq 90\text{mL/min}/1.73\text{m}^2$.

GFR eshte llogaritur sipas formules se Cockcroft-Gault, e cila paraqitet me poshtë:

$$eCr = \frac{(140 - \text{moshen}) \times \text{peshen(kg)} \times 0.85 \text{ per femrat}}{72 \times \text{kreatinina ne serum}(\frac{\text{mg}}{\text{dl}})}$$

- ❖ Ne studim jane perfshire edhe persona qe kane tolerance te demtuar te glukozes, me glicemi ne vlerat 100-125 mg/dl e matur esell.

II.2.4 Menyrat e diagnostikimit

Pacientet u diagnostikuani me kalkuloze renale nepermjet ekzaminimeve imazherike si:

- ❖ Ekografise renale. Eshte perdorur nje aparat ekografik ALOKA me sonde lineare konvekse 3,5 MHZ. Imazhet ne veshke me hije posterior >2 mm u konsideruan gure.
- ❖ Ro-grafise direkte te aparatit urinar ku shihen guret rentgenopake.
- ❖ Urografia intravenoze sidomos per guret ne ureter.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

- ❖ CT skaneri helical pa kontrast sidomos ne rastet e gureve rentgenotransparente.

II.2.5 Mbledhja e te dhenave

Mbledhja e te dhenave u krye nepermjet plotesimit te nje fishe TIP, te perpiluar posacerisht per kete studim. Fisha permban te dhena te per gjithshme, te dhena antropometrike dhe te dhena laboratorike.

Me poshte paraqitet modeli i fishes se perdorur per kete pjese te studimit.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

PROTOKOLLI I NDJEKJES SE PACINTEVE ME KALKULOZE RENALE

Emri i pacientit: _____

Datelindja: _____ Gjinia: _____

Vendlindja: _____ Vendbanimi: _____

PAS: _____ PAD: _____

Pesha trupore (kg): _____ Gjatesia (m): _____

BMI: _____ Gjendja (sipas BMI): _____

TERAPIA ANTIHIPERTENSIVE:

[] ACE-I (po/jo)	[] ARB (po/jo)	[] β Bllokues (po/jo)	[] CCB (po/jo)	[] Diuretike (po/jo)
-------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------	-----------------------------

Duhanpires: [] Po [] Jo

EKZAMINIMET (VLERAT):

Natriuria	Natremia
-----------	----------

Kaliuria	Kalemia
----------	---------

Kalciuria	Kalcemia totale
-----------	-----------------

Kloruria	Kalciumi i jonizuar
----------	---------------------

Fosfaturia	Kloremia
------------	----------

Magneziuria	Fosfatemia
-------------	------------

Citraturia	Magnezemia
------------	------------

Uricuria	Parathormoni (PTH)
----------	--------------------

pH Urinar	Uricemia
-----------	----------

	Astrupograma
--	--------------

	Glicemja
--	----------

	Kolesteroli Total
--	-------------------

	TG
--	----

	HDL
--	-----

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Pacientet e diagnostikuar me kalkuloze renale (nepermjet ekzaminimeve imazherike si ekografi renale, Ro-grafi direkte apo CT skaner te aparatit urinar) iu nenshruan ekzaminimit te elektroliteve ne urinen e 24 oreve dhe pH Urinar.

Po ashtu u ekzaminuan elektrolitet ne gjak (Natriumi, Kaliumi, Kalciumi, Klori, Fosfatet, Magneziumi, Uricemia), Parathormoni, Astrupograma, Glicemia, Kolesteroli Total, Trigliceridet, HDL.

Te gjitha ekzaminimet laboratorike u kryen ne mengjes esell.

Pacientet u konsideruan hipertensive ne qoftese ishin diagnostikuar me pare per hypertension per te cilin merrnin dhe mjekim me antihipertensiv, apo nese mesatarja e presionit sistolik ne tre matje ishte ≥ 140 mmHg, ndersa ajo e presionit diastolik ≥ 90 mmHg.

Matja e tensionit arterial u be me sfingomanometer ne kushte qetesie, ku pacienti qendron ulur dhe pushon 5-10 min para se te matet presioni arterial.

Secilit pacient iu percaktua BMI sipas formules se meposhtme dhe me pas gjendja sipas BMI.

$$\text{BMI } (\text{kg}/\text{m}^2) = \text{Pesha } (\text{kg})/\text{Lartesi}^2 \text{ (m}^2\text{)}$$

Sipas kesaj formule kemi kategorizimin e meposhtem:

- $\text{BM I} < 18.5$ - Nenpeshe
- $\text{BMI } 18.5 \div 24.9$ - Normal
- $\text{BMI } 25.5 \div 29.9$ - Mbipeshe
- $\text{BMI} > 30$ - Obeze

Te dhenat mbi moshen, vendlindjen, vendbanimin, duhanpirjen, peshen dhe gjatesine u moren te mireqena nga deklarimet e pacienteve.

II.2.6 Kriteret e perjashtimit nga studimi:

- ❖ Prania e semundjeve te tjera qe crregullojne metabolizmin e elektroliteve dhe ujit (diabeti i shequerit, semundjet endokrine, semundjet inflamatore).
- ❖ Trajtimet qe ndikojne ne metabolizmin e elektroliteve (vitamina D, acetazolamide, preparatet anti-epilektike, steroidet).

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

- ❖ Paciente me kalkuloze renale te cilet nuk iu nenshtuan matjes se elektroliteve ne urinen e 24 oreve, duke u perjashtuar nga studimi.

II.3 ANALIZA STATISTIKORE

Per analizen te dhenave eshte perdorur fisha epidemiologjike, e prezantuar me siper, e konsultuar me literatoren perendimore dhe arritjet me te fundit ne fushen e kalkulozes renale por edhe te nefrologjise per te bere te mundur marrjen e informacionit sa me te sakte dhe te hollesishem.

Te dhenat si fillimishte jane pasqyruar ne MS EXEL dhe se me tej u perpunuau ne SPSS (Statistical Program for Social Sciences, Version 17 Chikago Illionis) per analize te metejshme statistikore.

- Per te dhenat kategorike si gjinia, vendbanimi, vendlindja, perdorimi i medikamenteve antihypertensive (ACE-inhibitore, ARB, Calciblokues, Beta-blokues, Diuretike) dhe duhanpirjes u llogariten frekuencat perkatese.
- Analiza e H^2 u realizua per gjetjen e lidhjeve kategorike midis BMI dhe Gjinise, midis duhanpirjes dhe gjinise dhe presionit arterial (HTA/JO HTA) sipas gjinise.
- Per te dhenat mosha, dhe variablat e vazhdueshme qe jane vlerat e matura ne gjakun e subjekteve:
Natremise, Kalemise, Kalcemise Totale, Kalciumit te Jonizuar, Kloremise, Magnezemise, Fosfatemise, Uricemise, PTH-it, Astrupogrames, Glicemise, Kolesterolit Total, TG-ve, HDL-se, u llogariten mesataret dhe deviacioni standart.
- Per vlerat e marra ne urinen e 24 oreve:
Natriurise, Kaliurise, Kalciurise, Klorurise, Fosfaturise, Citraturise, Uricurise, dhe pH Urinar, u llogariten mesataret dhe deviacioni standart.

Per gjetjen e lidhjeve perkatese midis Presionit Arterial (HTA, jo-HTA) dhe variablate te vazhdueshme u be analiza statistikore e ANOVES per te pare ne se ekzistonin diferenca te rendesishme statistikore ne variablat e vazhdueshme ne subjekte me HTA dhe ato Normotensive.

Analiza e ANOVES u realizua edhe ne rastin e lidhjeve midis kalkulozes renale dhe gjinise (Meshkuj:Femra) me variablat e vazhdueshme qe shprehin te dhenat ne gjak dhe ne urinen 24 oreshe.

Analiza e ANOVES u realizua gjithshatu edhe ne rastin e lidhjeve midis kalkulozes renale dhe BMI-se me variablet e vazhdueshme qe shprehin te dhenat ne gjak dhe ne urinen 24 oreshe.

Me vlera domethenese statistikore u konsideruan te dhenat per te cilat nga analiza statistikore, rezulton se vlera e $P \leq 0.05$.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

II.4 REZULTATET E STUDIMIT

II.4.1 Studimi i shperndarjes te te dhenave sipa Moshes, Gjinise, Gjeografise, Duhanpirjes dhe Mjekimit te HTA

Me poshte po japim te dhenat per rezultatet e studimit te pasqyruara ne forma tabelore dhe me ane te grafikeve perkates.

Interpretimi i ketyre te dhenave jepet jepet ne Tabelen 1.

Tabela 1. Vlerat mesatare dhe deviacioni standart per te dhenat e vazhdueshme


NR.	TE DHENAT E VAZHDUESHME	N	Minimum	Maksimum	Mesatare	Deviacioni Standart
1.	Mosha	100	19.0	67.0	40.9	12.2
2.	Sistoliku	100	100.0	170.0	129.9	16.8
3.	Diastoliku	100	60.0	100.0	81.4	10.2
4.	Pesha	100	59.0	103.0	81.4	11.0
5.	Gjatesia	100	156.0	190.0	173.4	7.6
6.	BMI	100	24.3	36.1	30.1	26.3
7.	Kalciuria	100	108.0	950.0	337.4	129.8
8.	Fosfaturia	100	0.2	2.9	1.0	0.4
9.	Natriuria	100	65.0	142.0	96.3	11.5
10.	Magneziuria	100	1.9	5.8	3.5	0.8
11.	Citraturia	100	140.0	960.0	397.0	160.3
12.	Uricuria	100	280.0	1600.0	793.2	353.0
13.	Kloruria	100	124.0	242.0	184.7	27.9
14.	Phurinar	100	5.0	8.0	6.2	0.6
15.	Natremia	100	133.0	144.0	139.6	2.5
16.	Kalemia	100	3.2	5.2	4.3	0.4
17.	Kalcemiatotale	100	7.5	10.8	9.5	0.6
18.	Kalciumijonizuar	100	1.1	1.4	1.2	0.1
19.	Kloremia	100	96.0	110.4	101.3	3.8
20.	Fosfatemia	100	2.1	5.0	3.5	0.6
21.	Magnezemia	100	1.7	2.7	2.0	0.2
22.	Parathormoni	100	15.5	82.0	47.1	12.7
23.	Uricemia	100	2.1	9.8	5.2	1.4
24.	PH	100	7.4	7.4	7.4	0.0
25.	PCO2	100	35.0	46.0	41.5	2.8
26.	PO2	100	85.0	106.0	95.6	5.4
27.	HCO3	100	21.0	25.0	23.4	1.0
28.	TCO2	100	20.0	25.0	21.5	1.3
29.	BE excess	100	-2.0	3.0	0.5	1.3
30.	O2SAT	100	95.0	98.0	96.6	0.8

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial"

31.	Glicemia	100	76.0	110.0	95.0	7.8
32.	Kolesterolitota	100	135.0	353.0	195.1	37.9
33.	Trigliceridi	100	30.0	383.0	146.3	63.4
34.	HDL	100	30.0	77.0	46.2	9.6


Shperndarja e subjekteve sipas gjinise jepet ne figuren 11.

Figura 11. Shperndarja sipas gjinise



Ne studimin tone kemi marre 100 paciente me kalkuloze renale, nga te cilet meshkuj jane 59, 59% dhe femra 41, 41 %.

Figura 12. Mosha mesatare dhe deviacioni standart sipas gjinise




"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial"

Per subjektet e marra ne studim rezulton:

- Mosha mesatare per meshkuj eshte 41.03 vjec, dhe deviacioni standart eshte 10.00 vjet.
- Mosha mesatare per femrat eshte 40.63 vjec dhe deviacioni standart eshte 14.96 vjet.

Vlerat mesatare te moshes per meshkuj dhe femra jane te peraferta dhe nuk kane diference statistikore te rendesishme ($P = 0.8$).


Figura 13. Shperndarja e subjekteve sipas vendlindjes



Sic shihet ne figuren e mesiperme, shperndarja e rasteve me kalkuloze sipas vendlindjes eshte ne te gjithe vendin me predominim te dukshem te atyre nga Tirana (37%).


“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Figura 14. Shperndarja e subjekteve sipas vendbanimit



Sic shihet ne figuren e mesiperm, subjektet me vendbanim ne Tirane perbejne pjesen me te madhe te rasteve me kalkuloze (53 %). Ne rrethet e tjera shperndarja e tyre sipas vendbanimit eshte e perafert.


Figura 15. Shperndarja e subjekteve sipas BMI dhe gjinise



"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial"

Ne Figuren e mesiperme kemi pasqyruar shperndarjen e subjekteve sipas Treguesit te Mases Trupore (BMI) dhe asaj Gjinore. Vihet re se personat *Mbipeshe* dhe *Obeze* jane me te shprehur tek meshkujt sesa ne femrat, me nje domethenie statistikore shume te larte ($P = 0.0001$) te llogaritur me testin H^2 .


Figura 16. Shperndarja sipas gjinise dhe presionit arterial



Ne figuren me siper jepet shperndarja sipas presionit arterial (me HTA ose jo-HTA) dhe Gjinise, per rastet me kalkuloze renale te marra ne studim. Vihet re se meshkujt me hypertension jane ne numer me te madh se femrat hipertensive. Ne kete rast sipas analizes statistikore vlera e P e llogaritur me testin H^2 eshte 0.4, pra nuk paraqet sinjifikance statistikore.

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial"

Figura 17. Shperndarja e subjekteve duhanpires sipas gjinise




Ne grafik kemi pasqyruar shperndarjen e duhanpirjes sipas gjinise. Vihet re predominim i prevalences se duhanit ne meshkuj ne 66.0 %, krahasuar me femrat 0.0%. Domethenia statistikore eshte shume e larte ($P <0.005$) e llogaritur me testin H^2 .

Ne studim u pane dhe mjekimet qe perdornin pacientet per trajtimin e hypertensionit arterial.


“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Figura 18. Perdorimi i medikamenteve antihipertensive ACE-I



Ne studimin tone raste te trajtuar me ACE-I per trajtimin e HTA jane 12,12%.


Figura 19. Perdorimi i medikamenteve antihipertensive ARB



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Ne studimin tone raste te trajtuar me ARB per trajtimin e HTA jane 13.13%.


Figura 20. Perdorimi i medikamenteve antihipertensive β -bllokues



Ne studimin tone raste te trajtuar me β -bllokues per trajtimin e HTA jane 12.12%.


“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Figura 21. Perdorimi i medikamenteve antihipertensive kalcibllokues



Ne studimin tone raste te trajtuar me CCB per trajtimin e HTA jane 13.13%.

Figura 22. Perdorimi i medikamenteve antihipertensive diuretike



Perdorimi i diuretikeve ne pacientet tane me kalkuloze dhe hipertension ze 26.26%.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

II.4.2 Studimi i korelacionit te kalkulozes renale me vlerat e variablate ne gjak dhe urine sipas gjinise, bmi dhe presionit arterial, sipas analizes statistikore ANOVA

II.4.2.1 Te dhenat sipas gjinise

Tabela 2. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine sipas gjinise


GJINIA	Femra (N=41)		Meshkuj (N=59)		Total (N=100)		P
	Mesatare	Deviacioni Standard	Mesatare	Deviacioni Standard	Mesatare	Deviacioni Standard	
CITRATURIA	346.6	111	392.3	171	373.6	150.4	0.002
FOSFATURIA	1.1	0.5	1.1	0.4	1.1	0.5	0.815
KALCIURIA	327.7	109	335.1	140.5	332.1	128	0.776
KALIURIA	96.3	42.3	105.6	41.2	101.8	41.7	0.274
MAGNEZIURI	3.4	0.9	3.3	0.7	3.3	0.8	0.52
URICURIA	797.8	346.8	821	371.3	811.5	359.8	0.26
NATRIURIA	116.3	28.6	122.5	29.7	119.9	29.3	0.298
KLORURIA	214	34.6	219.1	44.7	217	40.8	0.543
PhUrinar	6.2	0.6	6.2	0.6	6.2	0.6	0.81

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Nga tabela e mesiperme vihen re ndryshime ne vlerat mesatare te Citraturise sipas gjinise, ku vlerat mesatare perkatese ishin me te larta ne meshkuj sesa ne femra ($P=0.002$)

Sic eshte dhene dhe ne Tabelen 1 vlerat mesatare te gjithe varialblave ne Urine, ne meshkuj ishin me te larta se ne femra por nuk u gjeten domethenie te tjera statistikore me perjashtim te Citraturise ($P = 0.002$). Kjo domethenie statistikore paraqitet dhe ne figuren e meposhtme.

Figura 23. Verat mesatare per citraturine sipas gjinise



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Tabela 3. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak sipas gjinise

Gjinia	Femra (N=41)		Meshkuj (N=59)		Total (M=F) (N=100)		P
GJAK/GJINI	Mean	Deviacioni Standard	Mean	Deviacioni Standard	Mean	Deviacioni Standard	
NATREMIA	139.6	2.5	139.5	2.4	139.6	2.5	0.851
KALEMIA	4.2	0.4	4.4	0.4	4.3	0.4	0.027
KALCEMIA	9.5	0.6	9.6	0.6	9.5	0.6	0.289
KALCIUMI	1.2	0.1	1.2	0.1	1.2	0.1	0.771
KLOREMIA	101.4	3.8	101.2	3.8	101.3	3.8	0.825
FOSFATEMIA	3.3	0.6	3.5	0.6	3.4	0.6	0.358
MAGNEZEMIA	2.0	0.2	2.0	0.2	2.0	0.2	0.37
PARATHORMO	46.2	12.6	47.7	12.8	47.1	12.7	0.566
URICEMIA	4.6	1.5	5.9	1.3	5.4	1.5	0.02
PH	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	0.566
PCO2	41.1	2.9	41.7	2.7	41.5	2.8	0.281
PO2	94.1	5.1	96.6	5.4	95.6	5.4	0.28
HCO3	23.2	0.9	23.5	1.0	23.4	1.0	0.179
TCO2	21.4	1.3	21.6	1.2	21.5	1.3	0.509
BEexcess	0.2	1.2	0.7	1.3	0.5	1.3	0.057
O2SAT	96.6	0.8	96.6	0.9	96.6	0.8	0.975
GLICEMIA	93.6	8.3	96.0	7.3	95.0	7.8	0.127
KOLESTEROLI	187.3	33.8	200.4	39.9	195.1	37.9	0.089
TRIGLICERIDE	122.1	54.1	165.1	63.5	147.5	63.2	0.001
HDL	49.2	9.2	43.6	9.1	45.9	9.5	0.003

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial"

Ne tabelen e mesiperme jane pasqyruar te gjithe vlerat bioikimike te variablate ne gjak per meshkuj dhe femra. Sic edhe shihet nga tabela vlerat mesatare sipas gjinise jane te njejtë ose te peraferta per Natremine, Kacumin Total dhe te Jonizuar, Kloremine, Fosfatemine, Magnezemine, PTH-In, Astrupogramen, Glicemine, Kolesterolin Total dhe nuk u gjeten domethenie statistikore ($P>0.05$).


Vlera mesatare e kaliumit tek meshkujt (4.4 mmol/L) eshte me e larte se vlera mesatare per femrat (4.2 mmol/L), ekziston një lidhje statistikore domethenese ($P=0.027$).

Gjithashtu:

- Vlera mesatare e uricemise tek meshkujt (5.9 mg/dl) eshte me e larte se vlera mesatare e uricemise per femrat (4.6 mg/dl), ($P = 0.02$).
- Vlera mesatare e TG tek meshkujt (165.1 mg/dl) eshte me e larte se vlera mesatare e TG-ve per femrat (122.1 mg/dl), ($P = 0.001$).
- Vlerat mesatare e HDL-ve tek meshkujt (43.6mg/dl) eshte me e ulet se vlera mesatare e HDL-ve per femrat (49.6 mg dl), ($P = 0.003$).

Kjo domethenie statistikore paraqitet dhe ne figuren e meposhtme.

Figura 24. Vlerat mesatare per variablat ne gjak sipas gjinise



II.4.2.2 TE DHENA SIPAS BMI

Tabela 4. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine sipas BMI

URINE/BMI	deri ne 21.9 (N=3)		22-24.9 (N=20)		25-29.9 (N=62)		mbi 30 (N=15)		Total (N=100)		P
	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	
Citraturia	399	19.8	380	124.2	367.3	168.8	301	111.9	373.6	150.4	0.04
Fosfaturia	0.9	0.3	1	0.4	1.2	0.4	1.3	0.6	1.2	0.5	0.02
Kalciuria	228	41.6	324.5	97.5	347	137.5	350.2	125.8	332.1	128	0.03
Kaliuria	71.3	29.1	63.2	26.2	113.6	38.4	111	42.2	101.8	41.7	0.0001
Magneziuria	4	0.3	3.3	0.7	3.3	0.8	3.4	0.7	3.3	0.8	0.5
Uricuria	721.7	140.1	736	359.7	801.4	349.2	988.7	398.9	811.5	359.8	0.02
Natriuria	84	18.5	97.3	12.4	126.2	27.3	131.7	35	119.9	29.3	0.0001
Kloruria	194.7	39.5	189.3	22.2	228.7	38.5	210.1	50.1	217.1	40.8	0.001
PhUrinar	7.2	1.02	6.4	0.46	6.2	0.6	5.7	0.3	6.2	0.6	0.0001

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Ne tabelen e mesiperme kemi te pasqyruar te gjithe vlerat e variablate te vazhdueshme ne urinen 24 oreshe sipas BMI-se.

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te Citraturise jane 399 mg, te cilat ulen ndjeshem me rritjen e BMI-se deri ne 301 mg ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P = 0.04$).

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te fosfaturise jane 0.9 g dhe rriten me rritjen e BMI-se deri ne 1.3 g ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P=0.02$).

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te kalciurise jane 228 mg dhe rriten me rritjen e BMI-se deri ne 350.2 mg ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P=0.03$).

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te kaliurise jane 71.3mmol dhe rriten me rritjen e BMI-se deri ne 111 mmol ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P = 0.0001$).

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te uricurise jane 721.7mg dhe rriten me rritjen e BMI-se deri ne 988.7mg ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P=0.02$).

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te natriurise jane 84 mEq dhe rriten me rritjen e BMI-se deri ne 131.7 mEq ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P = 0.0001$).


Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te klorurise jane 194.7mEq dhe rriten me rritjen e BMI-se deri ne 210.1 mEq ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P = 0.0001$).

Ne subjektet me BMI deri ne 21.9 vlerat mesatare te pH urinar jane 7.2 dhe ulen me rritjen e BMI-se deri ne 5.7 ne subjektet me $BMI > 30$ dhe me domethenie statistikore ($P = 0.0001$). Pra ekziston nje lidhje inverse midis pH urinar dhe BMI-se.

Kjo domethenie statistikore paraqitet dhe ne figuren e meposhtme.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Figura 25. Vlerat mesatare per variablat ne urine sipas BMI



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

Tabela 5. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak sipas BMI

BMI	Deri 21.9 (N=3)		22-24.9 (N=20)		25-29.9 (N=62)		mbi 30 (N=15)		Total (N=100)		P
	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	Mesatarja	Deviacioni standard	
Natremia	137.7	4.5	139.6	2.7	139.5	2.3	140.1	2.5	139.6	2.5	NS
Kalemia	4.0	0.2	4.1	0.3	4.3	0.4	4.5	0.6	4.3	0.4	NS
Kalcemia totale	9.6	0.7	9.4	0.6	9.6	0.6	9.6	0.7	9.5	0.6	NS
Kalciumi Jonizuar	1.2	0.0	1.2	0.1	1.2	0.1	1.3	0.1	1.2	0.1	NS
Kloremlia	99.7	2.1	101.3	3.9	101.5	3.5	100.8	5.0	101.3	3.8	NS
Fosfatemia	3.3	0.6	3.4	0.7	3.4	0.6	3.4	0.6	3.4	0.6	NS
Magnezemia	1.9	0.2	1.9	0.2	2.0	0.2	1.9	0.2	2.0	0.2	NS
Parathormoni	47.0	16.1	41.8	14.7	48.2	12.0	49.7	11.1	47.1	12.7	NS
Uricemia	4.2	1.8	4.2	1.1	5.5	1.2	6.4	2.0	5.4	1.5	0.001
Ph	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	NS
PCO ₂	40.7	2.1	40.8	2.8	41.6	2.7	42.1	3.1	41.5	2.8	NS
PO ₂	89.0	4.0	96.2	5.3	95.9	5.2	95.0	6.0	95.6	5.4	NS
HCO ₃	24.0	1.0	23.3	0.9	23.4	1.1	23.3	0.9	23.4	1.0	NS
TCO ₂	21.3	1.5	21.8	1.3	21.4	1.2	21.4	1.4	21.5	1.3	NS
BE	0.3	0.6	0.3	1.1	0.6	1.3	0.7	1.7	0.5	1.3	NS
O ₂ Sat	97.3	0.6	96.6	0.9	96.7	0.8	96.3	0.9	96.6	0.8	NS
Glicemja	86.3	3.8	89.9	5.2	95.6	7.1	101.1	8.6	95.0	7.8	0.001
Kolesteroli total	165.0	8.7	168.3	22.0	195.8	35.6	233.7	33.8	195.1	37.9	0.001
Trigliceridi	80.7	14.0	88.9	35.5	157.2	54.7	198.4	66.6	147.5	63.2	0.001
Hdl	54.0	10.1	51.6	7.1	45.3	9.5	39.1	7.1	45.9	9.5	0.0001


Ne tabelen e mesiperme paraqiten te dhenat biokimike tne gjak ne pacientet me kalkuloze renale. Sic vihet re vlerat mesatare te uricemise rriten ndjeshem me BMI-ne. Nga 4.2 mg/dl ne subjektet me BMI nen 24.9 ne 5.5 mg/dl dhe 6.4 mg/dl ne subjektet mbipeshe dhe obeze me nje domethenie statistikore te rendesishme ($P = 0.001$).

Me rritjen e BMI-se rriten vlerat mesatare edhe per glicemine, kolesterolin total dhe TG, ndersa per HDL u pa qe me rritjen e BMI-se vlerat mesatare uleshin pra ekziston nje lidhje inverse.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Pra ekziston nje lidhje sinjifikante midis BMI dhe: uricemise, glicemise, kolesterolit total, triglycerideve dhe HDL-se, $P < 0.005$, e pasqyruar dhe ne figuren e meposhtme.

Figura 26. Vlerat mesatare per variablat ne gjak sipas BMI



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

II. 4.2.3 TE DHENA SIPAS TENSIONIT ARTERIAL

Tabela 6. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine tek femrat hipertensive dhe normotensive

URINE / FEMRA								P	
	HTA (N=11)		Normal (N=30)		Total (N=41)				
	Mesatarja	Deviacioni Standart	Mesatarja	Deviacioni Standart	Mesatarja	Deviacioni Standart			
NATRIURIA	131.1	30.7	110.8	26.2	116.3	28.6	0.043		
KALIURIA	122.7	35.9	86.7	40.7	96.3	42.3	0.09		
KALCIURIA	327.8	142.8	327.4	96.7	327.7	109.0	0.2		
FOSFATURIA	1.4	0.7	1.0	0.4	1.1	0.5	0.016		
MAGNEZIURIA	2.9	0.8	3.6	0.9	3.4	0.9	0.031		
CITRATURIA	323.2	78.9	355.2	120.7	346.6	111.0	0.42		
URICURIA	873.6	379.8	670.0	336.3	797.8	346.8	0.0403		
KLORURIA	227.5	36.0	209.1	33.4	214.0	34.6	0.133		
PhUrinar	5.8	0.5	6.3	0.6	6.2	0.6	0.06		

Ne tabelen e mesiperme jepen vlerat mesatare te dhenave urinare per gjinine femerore, te detaujar per subjektet femra me HTA dhe normotensive.

Vlerat mesatare per natriurine, fosfaturine, uricurine, jane me te rritura ne femrat hipertensive ne krahasim me ato normotensive me nje domethenie statistikore ($P < 0.005$).

Ndersa vlerat mesatare te magneziurise ne femrat hipertensive (2.9 mmol) jane me te uleta se vlerat e magneziurise (3.6 mmol) ne femrat normotensive, ($P = 0.031$), pra ka nje domethenie statistikore.


Vlerat mesatare te citraturise ne femrat hipertensive (323.2 mg) jane me te uleta se vlerat mesatare te citraturise (355.2 mg) ne femrat normotensive ($P = 0.42$), por pa nje domethenie statistikore ($P > 0.05$).

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial”

I njejti rezultat edhe per kalciurine, kaliurine, klorurine dhe Ph urinar ($P > 0.05$).

Te dhenat per te cilat ka domethenie statistikore pasqyrohen ne figuren e meposhtme.

Figura 27. Vlerat mesatare per variablat ne urine ne subjektet femra me HTA dhe jo-HTA



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Tabela 7. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak tek femrat hypertensive dhe normotensive

GJAK/FEMRA (HTA)	FEMRA						P	
	HTA (N=11)		Normal (N=30)		Total (N=41)			
	Mesatarja	Deviacioni Standart	Mesatarja	Deviacioni Standart	Mesatarja	Deviacioni Standart		
NATREMIA	139.2	2.5	139.8	2.5	139.6	2.5	0.531	
KALEMIA	4.1	0.5	4.2	0.3	4.2	0.4	0.288	
KALCEMIA TOTALE	9.5	0.7	9.4	0.6	9.5	0.6	0.748	
KALCIUMI JONIZUAR	1.2	0.1	1.2	0.1	1.2	0.1	0.98	
KLOREMIA	101.8	4.0	101.2	3.8	101.4	3.8	0.669	
FOSFATEMIA	3.5	0.6	3.3	0.7	3.3	0.6	0.398	
MAGNEZEMIA	2.0	0.2	2.0	0.2	2.0	0.2	0.785	
PARATHORMONI	51.9	6.3	44.2	13.8	46.2	12.6	0.081	
URICEMIA	5.7	2.0	4.2	1.1	4.6	1.5	0.004	
PH	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	0.611	
PCO2	41.5	2.9	41.0	3.0	41.1	2.9	0.641	
PO2	91.5	3.4	95.1	5.3	94.1	5.1	0.45	
HCO3	22.7	0.9	23.4	0.9	23.2	0.9	0.34	
TCO2	21.1	1.0	21.5	1.3	21.4	1.3	0.365	
BEexcess	-0.5	1.4	0.5	1.0	0.2	1.2	0.27	
O2SAT	96.2	0.8	96.8	0.8	96.6	0.8	0.47	
GLICEMIA	103.8	4.3	89.8	5.8	93.6	8.3	0.001	
KOLESTEROLI TOTAL	224.6	28.8	173.7	23.9	187.3	33.8	0.002	
TRIGLICERIDET	175.3	42.5	102.6	44.2	122.1	54.1	0.001	
HDL	40.3	5.7	52.5	8.0	49.2	9.2	0.01	

Nga tabela Nr. 2 shohim qe vlerat mesatare te variablate ne gjak tek femrat hypertensive dhe normotensive jane te peraferta, por vihet re se vlerat mesatare te uricemise, kolesterolit total, TG, BMI-se jane me te larta tek femrat hypertensive ne krahasim me ato normotensive. ($P < 0.005$)

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Vlera mesatare e uricemise tek femrat hipertensive (5.7 mg/dl) eshte me e larte se tek ato normotensive (4.2 mg/dl). Pra kane nje diference statistikore te rendesishme ($P = 0.004$).

Vlera mesatare e glicemise tek femrat hipertensive (103.8 mg/dl) eshte me e larte se tek ato normotensive (89.8 mg/dl). Pra ka nje diference statistikore te rendesishme ($P = 0.001$).

Vlera mesatare e kolesterolit total te femrat hipertensive (224.6 mg/dl) eshte me e larte se tek ato normotensive (173.7 mg/dl) dhe me nje domethenie statistikore ($P = 0.002$).


Vlera mesatare e TG te femrat hipertensive (175.3 mg/dl) eshte me e larte se tek ato normotensive (102.6 mg/dl) dhe me nje domethenie statistikore ($P = 0.001$).

Vlera mesatare e HDL-se te femrat hipertensive (40.3 mg/dl) eshte me e ulet se tek ato normotensive (52.5 mg/dl) dhe me nje domethenie statistikore ($P = 0.001$). Pra, ekziston nje lidhje inverse midis HDL-se dhe HTA.

Persa i perket HDL-se vihet re nje lidhje inverse pasi vlerat mesatare te saj jane me te uleta tek femrat hypertensive ne krahasim me ato normotensive. Pra ekziston nje lidhje statistikisht sinjifikative, $P < 0.005$.

Te gjitha sa u thane me lart paraqiten dhe ne figuren e meposhtme.

Figura 28. Vlerat mesatare per variablat ne gjak ne subjektet femra me HTA dhe jo-HTA



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Tabela 8. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine tek meshkujt hypertensive dhe normotensive

URINE/ MESHKUJ (HTA)	MESHKUJ						P	
	HTA (N=21)		Normal (N=38)		Total (N=59)			
	Mesatarja	Deviacion i Standart	Mesatarja	Deviacion i Standart	Mesatarja	Deviacion i Standart		
NATRIURIA	116.8	36.3	125.7	25.3	122.5	29.7	0.274	
KALIURIA	88.6	42.2	115.1	38.0	105.7	41.2	0.017	
KALCIURIA	375.9	115.6	261.4	137.5	335.1	140.5	0.002	
FOSFATURIA	1.0	0.5	1.1	0.4	1.1	0.4	0.202	
MAGNEZIURI	3.6	0.6	3.1	0.7	3.3	0.7	0.022	
CITRATURIA	465.7	204.3	351.7	136.1	392.3	171.0	0.013	
URICURIA	985.9	429.3	729.9	304.2	821.0	371.3	0.01	
KLORURIA	205.8	44.1	226.5	43.8	219.1	44.7	0.088	
PhUrinar	6.0	0.8	6.2	0.5	6.2	0.6	0.137	

Ne tabelen e mesiperme jane te pasqyruara vlerat mesatare te variablate ne urinen 24 orshe tek meshkujt hypertensive dhe normotensive.

Sic vihet re edhe nga tabela, vlerat mesatare per kalciurine (375.8 mg) jane me te larta ne meshkujt hypertensive ne krahasim me ata normotensive (261.4 mg) me nje domethenie statistikore ($P = 0.002$).

Per magneziurine vlerat mesatare tek meshkujt hypertensive (3.6 mmol) jane me te larta se tek meshkujt normotensive (3.1 mmol), me nje domethenie statistikore ($P = 0.0022$).


Per citraturine vlerat mesatare ne meshkujt hypertensive (465.7 mg) jane me te larta sese vlerat ne meshkujt normotensive (351.7 mg), me nje domethenie statistikore ($P = 0.0013$).

Per uricurine vlerat mesatare ne meshkujt hypertensive (985.9 mg) jane me te larta sese vlerat ne meshkujt normotensive (725.9 mg), me nje domethenie statistikore ($P = 0.01$).

Per kaliurine vlerat mesatare ne meshkujt hypertensive (88.6 mmol) jane me te larta sese vlerat ne meshkujt normotensive (115.1 mmol), me nje domethenie statistikore ($P=0.017$).

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial"

Figura 29. Vlerat mesatare per variablat ne urine ne subjektet meshkuj me HTA dhe jo-HTA



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Tabela 9. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak tek meshkujt hypertensive dhe normotensive

GJAK / MESHKUJ (HTA)	MESHKUJ						P	
	HTA (N=21)		Normal (N=38)		Total (N=59)			
	Mesatari	Devacioni Standart	Mesatari	Devacioni Standart	Mesatari	Devacioni Standart		
NATREMIA	139.8	2.2	139.4	2.6	139.5	2.4	0.472	
KALEMIA	4.5	0.6	4.3	0.3	4.4	0.4	0.027	
KALCEMIATOTALE	9.7	0.7	9.5	0.6	9.6	0.6	0.205	
KALCIUMIJONIZUAR	1.3	0.1	1.2	0.1	1.2	0.1	0.809	
KLOREMIA	101.4	4.0	101.1	3.8	101.2	3.8	0.736	
FOSFATEMIA	3.4	0.6	3.5	0.6	3.5	0.6	0.871	
MAGNEZEMIA	2.0	0.3	2.0	0.2	2.0	0.2	0.522	
PARATHORMONI	53.3	13.1	44.6	11.7	47.7	12.8	0.011	
URICEMIA	6.7	1.6	5.4	0.7	5.9	1.3	0.002	
PH	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	0.192	
PCO2	42.1	2.6	41.5	2.8	41.7	2.7	0.422	
PO2	95.1	5.7	97.5	5.1	96.6	5.4	0.111	
HCO3	23.7	1.1	23.4	1.0	23.5	1.0	0.341	
TCO2	21.5	1.2	21.6	1.3	21.6	1.2	0.707	
Beexcess	1.1	1.2	0.5	1.3	0.7	1.3	0.093	
O2SAT	96.5	1.0	96.7	0.8	96.6	0.9	0.567	
GLICEMIA	99.0	8.9	94.3	5.8	96.0	7.3	0.018	
KOLESTEROLITOTA	228.4	49.5	185.0	22.0	200.4	39.9	0.02	
TRIGLICERIDI	197.1	72.5	147.4	50.7	165.1	63.5	0.003	
HDL	39.9	9.0	45.7	8.6	43.6	9.1	0.017	

Ne tabelen e mesiperme jane pasqyruar vlerat mesatare dhe devacioni standart per variablat e vazhdueshme te matur ne gjak tek meshkujt hypertensive dhe normotensive.

Vihet re qe vlerat mesatare te variablate jane te peraferta, me perjashtim te vlerave mesatare te kalemise, PTH-it, kolesterolit total, TG, HDL-se dhe BMI-se per te cilet ka nje domethenie statistikore ($P < 0.005$).

Vihet re qe vlerat mesatare te kaliumit ne meshkujt hypertensive jane 4.5 mmol/l, ndersa ne meshkujt normotensive 4.2 mmol/l me nje domethenie statistikore ($P = 0.027$).

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial"

Vihet re qe vlerat mesatare te PTH-it ne meshkujt hypertensive jane 53.3 pg/ml, ndersa ne meshkujt normotensive 44.6 pg/ml me nje domethenie statistikore ($P = 0.011$).

Vihet re qe vlerat mesatare te uricemise ne meshkujt hypertensive jane 6.7 mg/dl, ndersa ne meshkujt normotensive 5.4 mg/dl me nje domethenie statistikore ($P = 0.002$).

Vihet re qe vlerat mesatare te glicemise ne meshkujt hypertensive jane 99 mg/dl, ndersa ne meshkujt normotensive 94 mg/dl me nje domethenie statistikore ($P = 0.018$).


Vihet re qe vlerat mesatare te kolesterolt total ne meshkujt hypertensive jane 228.4 mg/dl, ndersa ne meshkujt normotensive 184.9 mg/dl me nje domethenie statistikore ($P = 0.02$).

Vihet re qe vlerat mesatare te TG-ve ne meshkujt hypertensive jane 197 mg/dl, ndersa ne meshkujt normotensive 147.3 mg/dl me nje domethenie statistikore ($P = 0.003$).

Vihet re qe vlerat mesatare te HDL ne meshkujt hypertensive jane 39.9 mg/dl, ndersa ne meshkujt normotensive 45.7 mg/dl me nje domethenie statistikore ($P = 0.017$). Pra, lidhja eshte inverse.

Kjo te dhena paraqiten ne figuren e meposhtme.

Figura 30. Vlerat mesatare per variablat ne gjak ne subjektet meshkuj me HTA dhe jo-HTA



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

II.4.2.4 TE DHENA TOTAL (MESHKUJ + FEMRA)

Tabela 10. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne urine per Total (F + M), hipertensive dhe normotensive

URINE/TOTAL (HTA)	HTA (N=32)		Normal (N=68)		Total (N=100)		P
	Mesatari	Devacioni Standart	Mesatari	Devacioni Standart	Mesatari	Devacioni Standart	
NATRIURIA	121.7	34.7	119.1	26.6	119.9	29.3	0.684
KALIURIA	100.3	42.8	102.5	41.5	101.8	41.7	0.804
KALCIURIA	354.7	127.4	284.1	122.8	332.1	128.0	0.009
FOSFATURIA	1.1	0.6	1.1	0.4	1.1	0.5	0.503
MAGNEZIURI	3.3	0.8	3.3	0.8	3.3	0.8	0.95
CITRATURIA	416.7	183.5	353.3	128.6	373.6	150.4	0.049
URICURIA	947.3	410.3	747.6	317.0	811.5	359.8	0.009
KLORURIA	213.3	42.2	218.8	40.2	217.0	40.8	0.526
PhUrinar	5.9	0.7	6.3	0.5	6.2	0.6	0.004

Ne tabelen e mesiperme jane pasqyruar vlerat mesatare dhe devacioni standart per vlerat e variablate ne urine ne pacientet e marre ne studim, hipertensive dhe normotensive.

Shihet qe vlerat mesatare te kalciurise ne pacientet me hypertension jane me te larta (354.7 mg) ne krahasim me ata normotensive (284.1 mg), por me nje domethenie statistikore ($P = 0.009$).

Shihet qe vlerat mesatare te citraturise ne pacientet me hypertension jane me te rritura (416.7 mg) ne krahasim me ata normotensive (353.3 mg), por me nje domethenie statistikore ($P = 0.049$).


Shihet qe vlerat mesatare te uricurise ne pacientet me hypertension jane me te rritura (947.3 mg) ne krahasim me ata normotensive (746.6), por me nje domethenie statistikore ($P = 0.009$).

Shihet qe vlerat mesatare te pH urinar ne pacientet me hypertension jane me te ulura (5.9) ne krahasim me ata normotensive (6.3), por me nje domethenie statistikore ($P=0.004$). Pra, lidhja eshte inverse.

Kjo te dhena paraqiten ne figuren e meposhtme.

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hipertensionit arterial"

Figura 31. Vlerat mesatare per variablat ne urine ne subjektet Meshkuj + Femra me HTA dhe jo-HTA



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Tabela 11. Analiza e ANOVES per variablat e vazhdueshme te vlerave ne gjak ne total (M +F) hipertensive dhe normotensive

GJAK/ TOTAL (HTA)	HTA (N=32)		Normal (N=68)		Total (N=100)		P
	Mesatarja	Deviacion Standart	Mesatarja	Deviacion Standart	Mesatarja	Deviacion Standart	
NATREMIA	139.6	2.3	139.5	2.5	139.6	2.5	0.882
KALEMIA	4.4	0.6	4.2	0.3	4.3	0.4	0.147
KALCEMIA	9.7	0.7	9.5	0.6	9.5	0.6	0.191
TOTALE							
KALCIUMI JONIZUAR	1.3	0.1	1.2	0.1	1.2	0.1	0.826
KLOREMIA	101.6	4.0	101.2	3.7	101.3	3.8	0.608
FOSFATEMIA	3.5	0.6	3.4	0.6	3.4	0.6	0.605
MAGNEZEMIA	2.0	0.2	2.0	0.2	2.0	0.2	0.656
PARATHORMONI	52.8	11.1	44.4	12.6	47.1	12.7	0.002
URICEMIA	6.4	1.8	4.9	1.1	5.4	1.5	0.007
PH	7.4	0.0	7.4	0.0	7.4	0.0	0.2
PCO2	41.9	2.7	41.3	2.8	41.5	2.8	0.31
PO2	93.9	5.3	96.4	5.3	95.6	5.4	0.111
HCO3	23.3	1.1	23.4	0.9	23.4	1.0	0.341
TCO2	21.3	1.2	21.6	1.3	21.5	1.3	0.425
BEexcess	0.6	1.5	0.5	1.2	0.5	1.3	0.779
O2SAT	96.4	0.9	96.7	0.8	96.6	0.8	0.099
GLICEMIA	100.6	7.9	92.3	6.2	95.0	7.8	0.006
KOLESTEROLI TOTAL	227.1	43.0	180.0	23.3	195.1	37.9	0.008
TRIGLICERIDI	189.6	63.9	127.6	52.6	147.5	63.2	0.007
HDL	40.0	7.9	48.7	8.9	45.9	9.5	0.004

Ne tabelen e mesiperme jane pasqyruar vlerat mesatare dhe deviacioni standart i variablate te vazhdueshme ne gjak ne pacientet e marre ne studim hipertensive dhe normotensive.

Vihet re qe vlerat mesatare te PTH-it ne gjak tek pacientet hipertensive (52.8 pg/ml) jane me te larta se vleret e PTH-it ne pacientet normotensive (44.4 pg/ml) me nje domethenie statistikore ($P = 0.002$).

Vihet re qe vlerat mesatare te Uricemise ne gjak tek pacientet hipertensive (6.4 mg/dl) jane me te larta se vleret e uricemise ne pacientet normotensive (5.2 mg/dl) me nje domethenie statistikore ($P = 0.007$).

"Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial"

Vihet re qe vlerat mesatare te glicemise ne gjak tek pacientet hypertensive (100.6 mg/dl) jane me te larta se vleret e uricemise ne pacientet normotensive (92.3 mg/dl) me nje domethenie statistikore ($P = 0.006$).


Vihet re qe vlerat mesatare te kolesterolit total ne gjak tek pacientet hypertensive (227.1 mg/dl) jane me te larta se vleret e kolesterolit ne pacientet normotensive (180 mg/dl) me nje domethenie statistikore ($P = 0.008$).

Vihet re qe vlerat mesatare te TG ne gjak tek pacientet hypertensive (189.6 mg/dl) jane me te larta se vleret e TG ne pacientet normotensive (127.6 mg/dl) me nje domethenie statistikore ($P = 0.007$).

Vihet re qe vlerat mesatare te HDL ne gjak tek pacientet hypertensive (40.0 mg/dl) jane me te ulura se vleret e HDL ne pacientet normotensive (48.7 mg/dl) me nje domethenie statistikore ($P = 0.004$). Lidhja eshte inverse.

Kjo domethenie statistikore pasqyrohet ne figuren e me poshtme.

Figura 32. Vlerat mesatare per variablat ne gjak ne subjektet Meshkuj + Femra me HTA dhe jo-HTA



“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

II.5 DISKUTIMI

Incidenca dhe prevalanca e gureve renale po rritet ne vitet e fundit. Kerkimet mbi kalkulozen vazhdojne te kene rendesi si rezultat i potencialit te semundjes per te shkaktuar kosto dhe morbiditet te larte.

Faktoret madhore te riskut per kalkuloze perfshijne moshen, gjinine, etnicitetin, historine familjare, historine per guret, hiperkalciurine, hiperoksalurine, hiperurikozurine, hipocitraturine dhe rrregullimet e pH urinar. Thuhet qe nje diete jo e pershatshme rrit prevalencen per mbipeshe te njerezve dhe ndryshimet e stilit te jetes jane perqegjese per shtimin e prevalences per gure ne 2-3 dekadat e fundit.

Ne studimin tone u vure qe meshkujt me gure ishin ne perqindje me te larte se femrat (59-41%), por pa nje domethenie statistikore.

Mosha dhe gjinia jane faktore risku per formimin e gureve renale. Urolithiaza eshte me prevalente tek meshkujt sesa tek femrat (kjo vertetohet nga Brenner dhe Rector 2008 [127], Ramello ne 2000 [135], Trinchieri ne 2008 [133], observimet flasin per raport 3:1. Prevalanca e gjinise i atribuohet differences ne diete ku meshkujt per shkak te konsumit te tepert kane urine me te koncentruar, gje qe con ne ndryshimet e ekskretimit urinar te promotoreve dhe inhibitoreve te litogenezes. Curhan dhe koleget e tij kane gjetur ekskretim te rritur urinar te promotoreve te gurit si: kalciumit, oksalateve, acidit urik dhe natriumit ne meshkuj dhe femra. Kurse femrat u prezantuan me citrate te rritura ne urine, gje qe inhibon formimin e gureve. (Curhan 2001) [130].

Guret ne veshka jane me te zakonshem ne adultet e moshes 30-50 vjec (nga Brenner dhe Rector 2008 [127], Trinchieri ne 2008 [133], dhe Ferrari 2007 [129]).

Gjate dy dekadave te fundit, nje renie e raportit meshkuj / femra eshte observuar nga Vijay 2009 [131], Scales 2007 [134], Strope 2010 [132]. Studimet epidemiologjike tregojne nje rritje te incidences per urolitiazet, sidomos tek femrat te vertetuar dhe nga studiuesit e mesiperme.

Ne nje studim prospektiv me 1091 femra dhe 7499 meshkuj me gure, Vijay [131] konkludoqi qe perqindja e femrave me gure rritej nga 8% ne periudhen 1971- 1975 ne 17% nga 2003-2008. Ndryshimet ne ekskretimin urinar te komponenteve te ndryshem tek femrat shpjegohet ne kete menyre: me kalimin e viteve tek femrat ekskretimi i kalciumit dhe oksalateve rritet nderkohe qe ekskretimi i magnezit ulet. Keto ndryshime ne ekskretim shpesh i atribuohen ndryshimeve ne standartin e jeteses dhe ne zakonet dietetike (Vijay 2009).

Tek ne rezultoi qe meshkujt eleminojnë me shume acid urik, natrium, calcium, citrate dhe me pak magnez ne urine dhe njelloj fosfor. Studimi rezultoi sinjifikant vetem per citratet ne urine. Si rrregull ne matjen 24 oreshe te citrateve ne urine ne subjekte jogureformues rezulton qe vlera e citraturise eshte me e rritur tek femrat sesa tek

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

meshkujt. Megjithate hipocitraturia eshte me e zakonshme ne femrat gureformuese sesa tek meshkujt, gje e cila vihet re edhe ne studimin tone.

Ne studimin tone ne morem ne konsiderate edhe lidhjen qe ekziston midis meshkujve duhanpires dhe jo duhanpires, ku rezultoi nje lidhje sinjifikante $P<0,005$ midis duhanpiresve me nefrolitiaz.

Ne nje studim te Tamadon, Nassaji, Ghorbani [136] u observua lidhja midis duhanpiresve me nefrolitiaz ne meshkujt adulte. U moren ne studim 102 raste me kalkuloze dhe 121 raste grup kontrolli pa gure nga 2010-2011. Te dy grupet ishin duhanpires. Tek grapi i dyte rritej dukshem rreziku per nefrolitiaz. Nuk u pa nje lidhje sinjifikante me numrin e cigareve dhe vitet e duhanpirjes.

Disa autore kane vene re se elementet ne perberjen e duhanit si: magnezi, alumini, zinku, hekuri, kadmiumi kane nje rol ne litogjeneze. Kadmiumi indukton disfunkcion glomerular ne duhanpiresit pasi tek keta te fundit eshte i rritur perqendrimi i tij ne gjak.

Duhanpirja eshte 2.06 here me e shprehur tek rastet me nefrolitize sesa tek grupet e kontrollit. Ky studim sygjeroi qe konsumi i duhanit mund te jete nje faktor rrisku per zhvillimin e nefrolitiaz. Duhanpirja ul fluksin urinar dhe rrit kadmiumin serik. Ne pacientet pa gure, gjithashtu duhanpirja rrit nivelet plazmatike te arginine-vazopresines, duke ulur diurezen dhe duke cuar ne gureformim. Nga ana tjeter duhanpirja mund te rrise prodhimin e radikaleve te lira te oksigjenit dhe stresin oksidativ ne veshke duke cuar ne demtim te saj. Keto demtime rritin agregimin e kristaleve duke cuar ne formimin e gureve. Ne kete studim nuk eshte marre nje grup i madh rastesh dhe nuk eshte studiar tipi i gureve.

Studimet epidemiologjike kane treguar se diabeti mellitus, sindromi metabolik dhe obeziteti rritin rrezikun per semundje te gureve renale. Sindromi metabolik eshte nje problem i rendesishem qe prek 20-30% te popullates te per gjithshme [83]. Sindromi metabolik percaktohet nga prania tek pacienti e te pakten 3 prej kritereve te me poshtme:

1. Obeziteti qendror (Perimetri abdominal >102 cm tek meshkujt dhe >88 cm tek femrat).
2. Ulja e HDL kolesterolit (<40 mg /dl tek meshkujt dhe <50 mg/dl tek femrat).
3. Trigliceridemia >150 mg/dl.
4. HTA $> 130/85$ mmHg.
5. Rezistenca insulinike (rritia e shpejte e glukoza ne gjak - 100 mg/dl ose me shume).

Zhvillimi i sindromit metabolik mendohet te shfaqet prej nderveprimeve gjenetike, akumulimit visceral te indit adipoz, rezistences insulinike, jetes sedentare. Tek pacientet me tre kriter te sindromit metabolik eshte dyfish probabiliteti per te patur gure renale dhe ky probabilitet trefishohet tek pacientet qe i plotesojnë te 5 kriteret. Sindromi metabolik njihet si faktor qe shkakton formim me te shtuar te gureve te acidit urik, por studimet e fundit thone qe ai rrit riskun edhe per guret kalcike [83, 84]. Lidhja e

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

komponenteve te sindromit metabolik, diabetit, HTA dhe obezitetit, ne formimin e gureve renale eshte treguar prej shume studimesh [85-91].

Diabeti mellitus eshte nje semundje e zakonshme qe mund te shkaktoje nje sere cregullimesh te sistemit urinar. Studimet e fundit kane treguar nje lidhje positive midis diabetit dhe gureve renale. Rritja e acidifikimit te urines, hipocitraturia, hiperoksaluria, hiperfosfaturia dhe hiperkalciuria jane mekanizma fizpatologjike perqegjes per formimin e gureve urinare. Ne nje kerkim ku u perfshire 3 grupe te medha me 200.000 paciente Taylor vleresoit lidhjen midis diabetit dhe gureve renale. Rezultati i studimit ishte qe njerezit me moshe te avancuar dhe me nje histori per gure renale kishin mundesi te rritura per diabet [137].

Ne nje studim NHANES tek adultet pjesemarres nga 2007-2010 u studiuva agravimi i diabetit dhe prezenca e gureve por nuk u gjet lidhje sinjifikante [139].

Ne nje studim te gjere te kalkulozes ne Japoni, Kohjimoto dhe bashkepunetoret e tij gjeten qe, dyslipidemia lidhet me rritjen e frekuences dhe rekurences te gureve te ndryshem, pavaresisht moshes, seksit, gjinise dhe prezences se kritereve te tjera te sindromit metabolik. Gjithashtu ata perdoren definicionin e dislipidemise (LDL kolesterol ≥ 140 mg/dl, HDL < 40 mg/dl, ose TG ≥ 150 mg/dl). Autoret gjithashtu konfirmuan qe vetem dyslipidemia lidhej ne menyre te pavarur me ndryshimet e elektroliteve ne urine perfshire hiperkalciurine, hiperurikozurine, hiperoksalurine dhe hipocitraturine.[11] Keto gjetje te dislipidemise ngrejne mundesine e pjesemarrjes te nje mekanizmi te zakonshem si rezistenca insulinike, stresi oksidativ, inflamacioni qe mund te kontribuojne ne nefrolitiazene sindromin metabolik [138].

Torricelli dhe bashkeautoret e tij[142] studiuau 2442 paciente me nefrolitiazene qe iu nenshtuan elektroliteve ne urinen e 24 oreve dhe profilit lipidik. Ata gjeten qe perqendrimi serik i komponenteve lipidik korelonte me ndryshimet urinare. Kolesteroli i rritur lidhej me hiperkaliurine dhe hiperkalciurine, nderkohe ulja e HDL ose nivelet e rritura te TG lidheshin me rritjen e: natriurise, oksalaturise dhe acidit urik dhe nje ulje te pH urinar [142], te dhena qe perputhen dhe me stidimin tone. Per me teper, nje nivel i rritur i kolesterolit apo TG lidhej me nje rrisk te larte per formimin e gureve te acidit urik [142].

Cho dhe koleget e tij [146] ne nje studim me 722 paciente me nefrolitiazene ne Korene e Jugut gjeten nivele sinjifikante te acidit urik, pH urinar te ulur dhe nje perqindje te rritur te gureve te acidit urik ne pacientet me sindrom metabolik. U vu re qe rritja e TG dhe reduktimi i HDL lidheshin me nje rritje te acidit urik. Megjithate mbas korrigjimit per moshen, gjinine, vetem rritja e TG ishte statistikisht sinjifikante.

Ne nje studim tjeter u vezhguar roli i statinave ne formimin e gureve ne pacientet me hiperlipidemi. Sur raportoi [147] rezultatet e 57232 subjekteve me hiperlipidemi dhe 1904 subjekteve me nefrolitiazene. Pacientet qe merrnin statina kishin risk me te ulet per kalkuloze sesa ata pa terapi, pra u pa nje lidhje sinjifikante.

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

Holoch dhe Tracy [140] investiguan historite e pacienteve me nefrolitiazet dhe perdorimin e antioksidanteve. Tek keta paciente u gjeten nivele te ulura te Alfa dhe Beta Karotenit, dhe Beta Kriptoksantines.

Ne studimin tone u gjet nje lidhje statistikore sinjifikante midis prezences se gureve, dhe BMI-se ($P < 0.005$).

Lidhja ndermjet HTA dhe kalkulozes eshte pershkruar se pari nga Morgagni ne vitin 1761 [89]. Madore gjeti se rrisku per zhvillimin e hypertensionit rritej mbas kalkulozes. Ne nje studim te Capuccio per nje periudhe ndjekjeje 8 vjecare u gjet se, rrisku per zhvillimin e kalkulozes ishte i larte ne pacientet hipertensive. Rritja e acidifikimit te urines, hipocitraturia, hiperoksaluria, hiperfosfaturia dhe hiperkalciuria jane mekanizma fiziopatologjike per formimin e gureve ne diabet [85, 87, 88].

Taylor ne nje studim te gjate gjeti qe incidenca dhe prevalanca e kalkulozes ishte e lidhur direkt me BMI-ne [92].

Ne nje studim te Taylor dhe Curhan[141] i quajtur Nurses Health Studies I dhe II gjeten qe pacientet me rritje te BMI ekskretonin me shume ne urine: oksalate, acid urik, natrium dhe fosfatet sesa ata me BMI te ulur. Ne pacientet obeze u vu re ulje e pH urinar si rezultat i disfunkzionit te ekskretimit te ammoniumit dhe acidifikimit te ammoniumit ne tubin proksimal. U pa nje lidhje inverse midis pH urinar dhe peshes trupore.

Gjithashtu kjo lidhje perputhet edhe me studimin tone ku u pa qe me rritjen e BMI-se, pH urinar ulet dhe perkatesisht 5.7. Autoret konkluduan qe gjetjet e tyre te lidhjes positive te BMI dhe ekskretimit te kalciumit urinar ishin si rezultat i ndryshimeve ne proteina shtazore dhe natriumit te konsumuar [141]. Ata besuan qe rritja e incidences per nefrolitiazet ne subjektet obeze ka shume te ngjare qe te jete si rezultat i rritjes se incidences te uricemise.

Observime te ngjashme u bene ne paciente me nefrolitiazet nga Desai dhe koleget e tij [143] ne nje studim retrospektiv me 256 paciente (145 meshkuj dhe 111 femra). Ata gjeten [143] qe rritja e BMI rrit riskun per gure te oksalateve te calciumit, fosfateve te kalciumit, dhe te acidit urik me lidhje positive midis BMI dhe natriumit urinar dhe oksalateve te kalciumit.

Eisner ne nje studim retrospektiv me 880 paciente gjeti qe rritja e BMI ishte e lidhur me faktoret e riskut per kalkuloze [90].

Cameron dhe koleget e tij [148] konfirmuan nje lidhje inverse midis pH urinar dhe peshes trupore. Ata konkluduan qe risku kryesor per nefrolithiazet ne pacientet me diabet tip II eshte nje pH i ulet urinar.

Ne nje studim te Maalouf me 148 adulte qe njiheshin si gureformues dhe 44 prej te cileve me sindrom metabolik, autoret gjeten qe ata me sindrom metabolik kishin nje pH urinar me te ulet sesa ata pa sindrom metabolik dhe ata me pH acid persistent acid ishin

“Lidhja ndermjet kalkulozes renale, peshes trupore dhe hypertensionit arterial”

kontribues te gureve nga acidi urik [145]. U pa qe nje pH i ulet urinar eshte nje shenje e sindromit metabolik dhe lidhet me shkallen e rezistences insulinike.

Nje studim i Lee percaktoi qe guret e acidit urik jane me te shpeshte ne pacientet obeze, cka perputhet edhe me rastet e marra ne studimin tone. Tek keta paciente hiperurikozuria shpjegohet me: mbingarkesen ne purina, hiperoksalurine dhe hipocitraturine si rezultat i reabsorbimit tubular te citrateve. Pacientet obeze qe formojne gure per here te pare jane me te riskuar per te bere rekurence [86].

